



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 119

Tiranë – E martë, 8 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 37/2025, datë 16.6.2025	Për performancën energjetike të ndërtesave..... 17099
Dekret i Presidentit nr. 213, datë 3.7.2025	Për shpallje ligji..... 17124
Ligj nr. 46/2025, datë 26.6.2025	Për prodhimin, transportimin, tregtimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport..... 17125
Dekret i Presidentit nr. 215, datë 4.7.2025	Për shpallje ligji..... 17133
Dekret i Presidentit nr. 203, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17134
Dekret i Presidentit nr. 204, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17134
Dekret i Presidentit nr. 205, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17134
Dekret i Presidentit nr. 206, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17135
Dekret i Presidentit nr. 207, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17135
Dekret i Presidentit nr. 208, datë 3.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17135

Dekret i Presidentit nr. 209, datë 3.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	17136
Dekret i Presidentit nr. 210, datë 3.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	17136
Dekret i Presidentit nr. 211, datë 3.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	17136
Dekret i Presidentit nr. 212, datë 3.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	17136
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 2.7.2025	Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026–2028	17137
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 303, datë 3.7.2025	Për njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit	17140
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 630, datë 27.6.2025	Për ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në territorin e Republikës së Shqipërisë.....	17143
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 632, datë 30.6.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël.....	17144
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 633, datë 1.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	17144
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 634, datë 1.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut.....	17147
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 635, datë 1.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	17148
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 649, datë 3.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Letonisë.....	17150
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 655, datë 4.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Kosovës.....	17153

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 656, datë 4.7.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 397, datë 23.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Hungarisë” dhe për shfuqizimin e urdhrit nr. 46, datë 17.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”	17154
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 18, datë 1.7.2025	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan sh.a.....	17154
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 19, datë 1.7.2025	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a.....	17160
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 20, datë 1.7.2025	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Berat sh.a.....	17166
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Adriano Jaho.....	17171



LIGJ
Nr. 37/2025

PËR PERFORMANCËN ENERGJETIKE
TË NDËRTESAVE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim promovimin dhe përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë të emetuara si rezultat i përdorimit të tyre, duke konsideruar kushtet klimatike të jashtme, kushtet lokale, kërkesat për cilësinë e ambientit të brendshëm, nivelin e kostos optimale, me qëllim transformimin e ndërtesave ekzistuese në ndërtesa pa emetime deri në vitin 2050.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e:

- kuadrit për metodologjinë kombëtare të llogaritjes dhe vlerësimit të performancës energjetike të ndërtesave dhe njësive të tyre;
- kërkesave minimale për performancën energjetike të ndërtesave të reja, si dhe të atyre ekzistuese që do t'i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm;
- rregullave për shfrytëzimin e energjisë diellore, përmirësimin e infrastrukturës për lëvizshmëri të qëndrueshme, certifikimin e performancës energjetike dhe auditimin e sistemeve teknike të

ndërtesave, duke siguruar zvogëlimin e konsumit energjetik dhe rritjen e cilësisë së ambientit të brendshëm të ndërtesave.

Neni 3
Fusha e zbatimit dhe përjashtimet

1. Ky ligj do të zbatohet për të gjitha ndërtesat e reja dhe ndërtesat që do t'i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm që nga faza e projektimit deri në pajisjen me leje shfrytëzimi, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit, si dhe për të gjitha ndërtesat ekzistuese.

2. Kategoritë e ndërtesave, që përjashtohen plotësisht ose pjesërisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, përfshirë zbatimin e kërkesave minimale, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, sipas kriterëve të mëposhtme:

- për shkak të meritave të tyre të veçanta arkitekturore ose historike për aq sa pajtueshmëria me kërkesat do të ndryshonte në mënyrë të papranueshme karakterin ose pamjen e tyre ose nëse rinovimi i tyre nuk është teknikisht ose ekonomikisht i realizueshëm;
- për shkak të tipologjisë së përdorimit, kushteve teknike, si dhe funksionimit të tyre;
- për shkak të kohëzgjatjes së përdorimit;
- për shkak të çështjeve që lidhen me sigurinë kombëtare.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

- “Cilësia e ambientit të brendshëm” është rezultati i vlerësimit të kushteve brenda një ndërtese që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve të saj, bazuar në parametra të tillë si ato që kanë të bëjnë me temperaturën, lagështinë, shkallën e ventilimit dhe praninë e ndotësve.
- “Energji e eksportuar” është sasia në përqindje e energjisë së rinovueshme, e shprehur për bartës energjetik dhe për faktorin e energjisë primare, që

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2024/1275 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 prill 2024, “Për performancën energjetike të ndërtesave”.



eksportohet në rrjetin elektroenergetik, në vend që të përdoret për vetëpërdorim në ndërtesë ose për përdorime të tjera në vendndodhjen e ndërtesës.

3. “Energji e shpërndarë” është energjia e shprehur për bartës energjetik, e furnizuar në sistemet teknike të ndërtesës përmes kufirit të vlerësimit, për të përmbushur përdorimet e marra në konsideratë ose për të prodhuar energjinë e eksportuar.

4. “Energji nga burimet e rinovueshme të prodhuara pranë” është energjia nga burimet e rinovueshme, të prodhuara brenda një perimetri në nivel lokal ose rrethi të një ndërtese të caktuar, e cila plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) mund të shpërndahet dhe të përdoret vetëm brenda atij perimetri të nivelit lokal dhe qarkut nëpërmjet një rrjeti të dedikuar shpërndarjeje;

b) lejon llogaritjen e një faktori specifik të energjisë primare të vlefshme vetëm për energjinë nga burimet e rinovueshme të prodhuara brenda atij perimetri të nivelit lokal ose qarkut;

c) mund të përdoret në vendndodhje nëpërmjet një lidhjeje të dedikuar me burimin e prodhimit të energjisë, ku kjo lidhje e dedikuar kërkon pajisje specifike për furnizimin dhe matjen e sigurt të energjisë për vetëpërdorim të ndërtesës.

5. “Familje në nevojë” janë familjet që trajtohen me asistencë sociale sipas ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ato që jetojnë në varfëri energjetike, të cilat janë veçanërisht të ekspozuara ndaj kostove të larta të energjisë dhe u mungojnë mjetet financiare për të rinovuar ndërtesën në të cilën jetojnë.

6. “Gjenerator nxehtësie” është pjesa e një sistemi ngrohjeje që gjeneron nxehtësi të dobishme për përdorim në ndërtesa, duke përdorur një ose më shumë nga proceset e mëposhtme:

a) djegien e lëndëve djegëse, për shembull, në një kaldajë;

b) efektin “Joule”, që ndodh në elementet ngrohëse të një sistemi ngrohjeje me rezistencë elektrike;

c) marrjen e nxehtësisë nga ajri i ambientit, ajri i larguar përmes ventilimit ose përmes një burimi nxehtësie (uji ose tokës) nëpërmjet përdorimit të një pompe nxehtësie.

7. “Impiant ftohës” është pjesa e një sistemi për kondicionimin e ajrit që përmes largimit të nxehtësisë krijon ftohje të dobishme për përdorime në ndërtesa.

8. “Kaldajë” është kombinim këmbyesi i nxehtësisë me djegësin, i projektuar për të transmetuar nxehtësinë që çlirohet nga procesi i djegies të fluidët ose bartësit e energjisë.

9. “Karikimi inteligjent” është një operacion rimbushjeje në të cilin intensiteti i energjisë elektrike që i dërgohet baterisë rregullohet në kohë reale, bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet komunikimit elektronik.

10. “Karikimi me dy drejtime” është një operacion rimbushjeje inteligjente ku kahu i energjisë elektrike mund të ndryshohet, duke lejuar që energjia elektrike të kalojë nga bateria në stacionin e karikimit me të cilën është lidhur.

11. “Kontraktimi i performancës energjetike” është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe ofruesit të një mase për përmirësimin e eficiencës energjetike, e verifikuar dhe e monitoruar gjatë gjithë afatit të kontratës, ku punët, furnizimi ose shërbimi në atë masë paguhet në lidhje me një nivel të dakordësuar të përmirësimit të eficiencës energjetike ose një kriter tjetër i dakordësuar i performancës energjetike, siç janë kursimet financiare.

12. “Kufijtë e vlerësimit” është kufiri ku matet ose llogaritet energjia e konsumuar dhe energjia e eksportuar.

13. “Nevoja për energji” është energjia që do t’i jepet ose do të merret nga një hapësirë e kondicionuar për të ruajtur kushtet e synuara të hapësirës gjatë një periudhe të caktuar kohore, pa marrë parasysh mosefikasitetin e sistemit teknik të ndërtesës.

14. “Në vendndodhje” është brenda ose në një ndërtesë të caktuar ose në tokën në të cilën ndodhet ajo ndërtesë.

15. “Vendpushim fizikisht ngjitur me ndërtesën” është parkimi i makinave, i cili është i destinuar për shfrytëzimin e banorëve, vizitorëve ose punëtorëve të një ndërtese dhe që ndodhet brenda zonës pronësore të ndërtesës ose është në afërsi të drejtpërdrejtë të ndërtesës.

16. “Përdorim i energjisë” ose “konsumi i energjisë” është hyrja e energjisë në sistemin teknik të ndërtesës, që ofron një shërbim PEN dhe synon të plotësojë një nevojë për energji.

17. “Përdorime të tjera në vendndodhje” janë përdorime në vendndodhje, përveç shërbimeve PEN, duke përfshirë pajisjet, ngarkesat e ndryshme



dhe ndihmë ose pikat e karikimit të makinave elektrike.

18. “Stacion karikimi” është një platformë fikse ose e lëvizshme, e lidhur me rrjetin ose jo për transferimin e energjisë elektrike në një automjet elektrik, i cili, megjithëse mund të ketë një ose më shumë konektorë për të akomoduar lloje të ndryshme konektorësh, është në gjendje të karikojë vetëm një automjet elektrik në të njëjtën kohë dhe që përjashton pajisjet me fuqi dalëse më të vogël ose të barabartë me 3.7 kW, qëllimi kryesor i të cilave nuk është karikimi i automjeteve elektrike.

19. “Sipërfaqja e dobishme e dyshemesë” është sipërfaqja e dyshemesë së një ndërtese që nevojitet si parametër për të përcaktuar sasinë e kushteve specifike të përdorimit që shprehen për njësi të sipërfaqes së dyshemesë dhe për zbatimin e thjeshtimeve dhe zonimit e rregullave të ndarjes ose rishpërndarjes.

20. “Sipërfaqja referente e dyshemesë” është sipërfaqja e dyshemesë së përdorur si madhësi referente për vlerësimin e performancës energjetike të një ndërtese, e llogaritur si shuma e sipërfaqeve të dobishme të dyshemesë së hapësirave brenda mbështjellësit të ndërtesës, të specifikuar për vlerësimin e performancës energjetike.

21. “Sistem ngrohjeje” është një kombinim i komponentëve të nevojshëm për të siguruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, me anë të të cilit temperatura kontrollohet ose mund të rritet.

22. “Standardet minimale të performancës energjetike” janë kërkesa që duhet të plotësojnë ndërtesat ekzistuese për të arritur një nivel të performancës energjetike si pjesë e një plani të gjerë rinovimi për një stok ndërtimi ose në një pikë nxitëse në treg, si: shitja, qiraja, dhurimi ose ndryshimi i qëllimit brenda kadastrës ose regjistrit të tokës, në një periudhë kohore ose në një datë të caktuar, duke shkaktuar kështu rinovimin e objekteve ekzistuese.

23. “Shërbime të lidhura me performancën energjetike të ndërtesave” ose “shërbime PEN” janë shërbime të tilla, si: ngrohja, ftohja, ventilimi, uji i ngrohtë dhe ndriçimi dhe të tjera për të cilat përdorimi i energjisë merret parasysh në llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave.

24. “Vetëpërdorim” është përdorimi i energjisë nga burimet e rinovueshme të prodhuara në vendndodhje ose të energjisë nga burimet e rinovueshme të prodhuara pranë nga sistemet teknike në vendndodhje për shërbimet PEN.

25. “Certifikata e performancës energjetike” është një dokument i lëshuar nga audituesi energjetik, ku përcaktohet performanca energjetike e një ndërtese ose e njësisë së një ndërtese, e përcaktuar dhe e lëshuar sipas kërkesave të këtij ligji.

26. “E matur” është matja e realizuar nga një pajisje përkatëse, si një matës energjie, një matës i fuqisë, një pajisje matëse dhe monitoruese e energjisë ose një matës i energjisë elektrike.

27. “Element i ndërtesës” është një sistem teknik i ndërtesës ose një element i mbështjelljes së ndërtesës.

28. “Emetimet e gazeve serrë gjatë gjithë ciklit jetësor” janë emetimet e gazeve serrë që ndodhin gjatë gjithë ciklit jetësor të një ndërtese, duke përfshirë prodhimin dhe transportin e produkteve të ndërtimit, aktivitetet në kantier, përdorimin e energjisë në ndërtesë dhe zëvendësimin e produkteve të ndërtimit, si dhe prishjen, transportin e menaxhimin e mbetjeve dhe ripërdorimin e tyre, riciklimin dhe asgjësimin përfundimtar.

29. “Emetimet e gazeve serrë gjatë përdorimit” janë emetimet e gazeve serrë që lidhen me konsumin energjetik të sistemeve teknike të ndërtesës gjatë përdorimit dhe funksionimit të ndërtesës, të shprehura në $\text{kgCO}_2\text{eq}/(\text{m}^2\cdot\text{y})$.

30. “Energji nga burime të rinovueshme” është energjia e gjeneruar nga burime të rinovueshme jofosile, përkatësisht, era, dielli (solare termike dhe fotovoltaike diellore) dhe energjia gjeotermale, energjia osmotike, energjia e ambientit, baticat, valët dhe energjitë e tjera të oqeanit, hidrocentralet, biomasa, gaz i landfillit, gaz i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi.

31. “Energjia primare” është energjia prej burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme, e cila nuk ka pësuar ndonjë proces transformimi ose shndërrimi.

32. “Interval llogaritjeje” është intervali kohor diskret që përdoret për llogaritjen e performancës energjetike.

33. “Kogjenerim” është gjenerimi i njëkohshëm i energjisë termike dhe elektrike dhe/ose energjisë mekanike nga një proces i vetëm.

34. “Librezë rinovimi” është një udhërrëfyes i përshtatur për rinovimin e thelluar të një ndërtese specifike që përshkruan një numër maksimal masash/ndërrhyrjesh që do të përmirësojnë ndjeshëm performancën e saj energjetike.



35. “Mbështjellësja e ndërtesës” janë elementet konstruktive dhe jokonstruktive të integruara të një ndërtese, të cilat veçojnë ambientin e brendshëm të saj nga ambienti i jashtëm.

36. “Ndërtesë banimi ose njësi e ndërtesës” është një dhomë ose një grup dhomash në një ndërtesë të përhershme ose një pjesë e ndarë strukturore e një ndërtese, e cila është projektuar për banim gjatë gjithë vitit nga një familje private.

37. “Ndërtesë pa emetime” është një ndërtesë me performancë shumë të lartë energjetike, që kërkon zero ose një sasi shumë të ulët energjie, që nuk gjeneron emetime të dioksidit të karbonit në vendndodhje nga karburantet fosile dhe gjeneron zero ose një sasi shumë të ulët të emetimeve operationale të gazeve serrë, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

38. “Ndërtesë” është një konstruksion i mbështjellë me çati/soletë/tarracë, dysheme dhe me mure, në të cilin energjia përdoret për të kondicionuar ambientin e brendshëm.

39. “Ngrohje qendrore” ose “Ftohje qendrore” është shpërndarja e energjisë termike në formën e avullit, ujit të nxehtë ose lëngjeve të ftohta, nga një burim qendror ose i decentralizuar prodhimi nëpërmjet një rrjeti tubacionesh, në ndërtesa ose vende të shumta për realizimin e ngrohjes ose ftohjes së ambienteve të brendshme ose realizimin e proceseve.

40. “Niveli i koston optimale” është niveli i performancës energjetike, i cili çon në koston më të ulët të mundshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë ekonomike të supozuar, ku:

a) kostoja më e ulët përcaktohet duke marrë parasysh:

i. kategorinë dhe përdorimin e ndërtesës në fjalë;

ii. kostot e investimeve të lidhura me energjinë në bazë të parashikimeve zyrtare;

iii. kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, përfshirë kostot energjetike dhe duke përfshirë gjithashtu edhe kostot për gazet me efekt serrë të lejuara;

iv. pasojat mjedisore dhe shëndetësore të përdorimit të energjisë;

v. fitimet nga energjia e prodhuar në vendndodhje, aty ku është e aplikueshme;

vi. kostot e menaxhimit të mbetjeve, aty ku është e aplikueshme;

b) cikli ekonomik i supozuar i jetëgjatësisë përcaktohet në metodologjinë krahasuese për përcaktimin e nivelit të koston dhe i referohet ciklit

ekonomik të supozuar të jetëgjatësisë për të gjithë ndërtesën, kur kërkesat e performancës energjetike përcaktohen për ndërtesën në tërësi, ose elementeve të ndërtesës kur kërkesat e performancës energjetike përcaktohen për element të ndërtesës.

Niveli i koston optimale duhet të jetë brenda intervalit të niveleve të performancës ku analiza kosto-përfitim e llogaritur gjatë ciklit të vlerësuar të jetës ekonomike është pozitive.

41. “Njësi e ndërtesës” është një seksion, një kat, një ndarje/apartament brenda një ndërtese, që është destinuar ose ndryshuar për t’u përdorur veçmas.

42. “Organet publike” janë autoritetet dhe subjektet kombëtare, rajonale ose vendore të financuara dhe të administruara drejtpërdrejt nga ato autoritete, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

43. “Parkim i mbuluar/parkim me strehë” është një ndërtim i mbuluar me çati, me të paktën tri vende parkimi makinash, që nuk përdor energji për të kondicionuar ambientin e brendshëm.

44. “Performanca energjetike e një ndërtese” është sasia e llogaritur ose e matur e energjisë që nevojitet për të plotësuar kërkesën për energji që lidhet me një përdorim tipik të ndërtesës, e cila përfshin energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë sanitar dhe ndriçim.

45. “Përdorim tipik i një ndërtese” është përdorimi i zakonshëm nga pikëpamja e funksioneve zonale, tipologjisë dhe numrit të personave në një ndërtesë dhe që merr parasysh qëllimin e përdorimit të ndërtesës, gjendjen e kushteve klimatike të mjedisit të jashtëm dhe kushtet e ambientit të brendshëm.

46. “Potenciali i ngrohjes globale gjatë ciklit jetësor” ose “PNG gjatë ciklit jetësor” është një tregues që përcakton kontributin sasior të potencialit të ngrohjes globale të një ndërtese përgjatë ciklit të saj të plotë jetësor, i shprehur në $\text{kgCO}_2\text{eq/m}^2$, (sipërfaqe të dobishme).

47. “Rinovim i konsiderueshëm” është rinovimi i një ndërtese ose njësie të ndërtesës, ku më shumë se 25 për qind e sipërfaqes së mbështjellës së ndërtesës i nënshtrohet rinovimit.

48. “Rinovim i thelluar me faza” është një rinovim i kryer në një numër maksimal hapash, sikurse përcaktohet në librezën e rinovimit.

49. “Rinovim i thelluar” është një rinovim që është në përputhje me parimin “eficienca në krye”, i cili fokusohet në elementet thelbësore të ndërtesës



dhe që transformon një ndërtesë ose njësi ndërtimi në një ndërtesë ose njësi ndërtimi pa emetime.

50. “Sistemet teknike të ndërtesës” janë pajisjet teknike të një ndërtese ose të një njësie ndërtese që shërbejnë për ngrohjen/ ftohjen e ambientit të brendshëm, ventilimin, gjenerimin e ujit të ngrohtë sanitar, ndriçimin e integruar, automatizimin dhe kontrollin e ndërtesës, prodhimin e energjisë së rinovueshme në vendndodhje dhe depozitimin e energjisë ose një kombinim i tyre, duke përfshirë ato sisteme që përdorin energji nga burime të rinovueshme.

51. “Sistemi i ventilimit” është kombinimi i komponentëve/elementeve që kërkohen për të siguruar këmbimin e ajrit të brendshëm me ajrin e jashtëm, në mënyrë natyrore ose përmes pajisjeve mekanike.

52. “Sistemi për automatizimin dhe kontrollin e ndërtesës” është një sistem që përfshin të gjitha produktet, programet kompjuterike dhe shërbimet inxhinierike që mund të mbështesin funksionimin eficient, ekonomik dhe të sigurt të sistemeve teknike të ndërtesave nëpërmjet kontrolleve automatike dhe duke lehtësuar ndërveprimin manual mbi sistemet teknike të ndërtesave.

53. “Standard evropian” është një standard i miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizim, Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik ose Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit dhe i vënë në dispozicion për përdorim publik.

54. “Standard shqiptar” është çdo dokument i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji për standardizimin dhe që shënohet me (SSH).

55. “Stimuj të ndarë” është mungesa e shpërndarjes së drejtë dhe të arsyeshme të detyrimeve financiare dhe shpërblimeve në lidhje me investimet në eficiencën e energjisë midis aktorëve të interesuar, për shembull, pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të njërive të ndërtesave të banimit, ose pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të ndërtesave me shumë qëllime përdorimi.

56. “Treguesi i energjisë primare të rinovueshme” është një tregues që llogaritet duke ndarë energjinë primare nga burimet e rinovueshme për një bartës të caktuar energjie, duke përfshirë energjinë e transferuar dhe humbjet

e përgjithshme të llogaritura të energjisë në pikat e përdorimit nga energjia e transferuar.

57. “Treguesi i energjisë primare të rinovueshme” është një tregues që llogaritet duke ndarë energjinë primare nga burimet e rinovueshme nga një burim energjie në vendndodhje, afër ose në distancë që transferohet nëpërmjet një bartësi të caktuar energjie, duke përfshirë energjinë e transferuar dhe energjinë e humbur për transmetimin e energjisë në pikat e përdorimit, nga energjia e transferuar.

58. “Treguesi total i energjisë primare” është shuma e treguesve të energjisë primare të rinovueshme dhe jo të rinovueshme për një bartës të caktuar energjie.

59. “Varfëri energjetike” është pamundësia e aksesit të një familjeje në shërbimet thelbësore energjetike, kur shërbime të tilla mundësojnë nivelin bazë dhe standarde të mira jetese dhe shëndeti, duke përfshirë ngrohjen, ujin e nxehtë, ftohjen, ndriçimin dhe energjinë për të furnizuar pajisjet elektrike, në kontekstin përkatës kombëtar, politikën sociale ekzistuese kombëtare dhe politikën e tjera përkatëse kombëtare, të shkaktuar nga një kombinim faktorësh, duke përfshirë, të paktën, të ardhura të pamjaftueshme, shpenzime të larta për energjinë e konsumuar, performancën e ulët energjetike të shtëpive, gjeografinë, statusin individual të subjektit për të krijuar të ardhura.

60. “Fuqia nominale efektive” është prodhimi maksimal kalorifik, i shprehur në kW, i specifikuar dhe i garantuar nga prodhuesi që gjenerohet gjatë operimit të vazhdueshëm, ndërkohë që është në përputhje me eficiencën e dobishme të treguar nga prodhuesi.

61. “Sistem për kondicionimin e ajrit” është një kombinim i komponentëve të nevojshëm për të siguruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, me anë të të cilit temperatura kontrollohet ose mund të ulet.

62. “Stoku i ndërtesave” është sasia totale e ndërtesave ekzistuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, qofshin këto publike apo private, rezidenciale apo jorezidenciale.



KREU II RINOVIMI I NDËRTESAVE

Neni 5 Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave

1. Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave është në përputhje me objektivat e përcaktuar dhe në të njëjtën linjë me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

2. Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave përfshin:

a) një përmbledhje të gjendjes së ndërtesave kombëtare për tipologji të ndryshme, duke identifikuar për çdo rast dhe pjesën që zënë në totalin e ndërtesave kombëtare, periudhat e ndërtimit dhe zonat klimatike, bazuar, sipas rastit, në të dhëna statistikore dhe bazën e të dhënave kombëtare për certifikatat e performancës energjetike, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji, një pasqyrë të barrierave dhe mosfunksionimit të tregut dhe një pasqyrë të kapaciteteve të sektorit të ndërtimit, eficiencës energjetike dhe burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe pjesën e ndërtesave të përdorura nga familje në nevojë bazuar, sipas rastit, në të dhëna statistikore;

b) një udhërrëfyes me objektiva të vendosur në nivel kombëtar dhe tregues të matshëm të progresit, duke përfshirë reduktimin e numrit të njerëzve të prekur nga varfëria energjetike, me synimin për të arritur objektivin e neutralitetit klimatik në vitin 2050, përmes një stoku kombëtar ndërtesash me eficiencë të lartë energjetike, të dekarbonizuar dhe transformimin e ndërtesave ekzistuese në ndërtesa pa emetime deri në vitin 2050;

c) një pasqyrë të politikave dhe masave të zbatuara e të planifikuara, që mbështesin zbatimin e udhërrëfyesit sipas shkronjës “b”;

ç) një përmbledhje të nevojave buxhetore për zbatimin e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, burimet dhe masat e financimit, si dhe burimet administrative për rinovimin e ndërtesave;

d) vlerat e lejuara të emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit dhe kërkesën vjetore për energji primare për një ndërtesë pa emetime, të re ose të rinovuar në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

dh) standardet minimale të performancës energjetike për ndërtesat jorezidenciale mbi bazën e

pragjeve maksimale të performancës energjetike në përputhje me nenin 6 të këtij ligji;

e) trajektoren kombëtare për rinovimin e stokut të ndërtesave të banimit, duke përfshirë objektivat 2030 dhe 2035 për përdorimin mesatar të energjisë primare në kWh/(m²·v) në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;

ë) një vlerësim (të bazuar në dëshmi) të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera, duke përfshirë ato që lidhen me garantimin e cilësisë së ambientit të brendshëm.

3. Udhërrëfyesi i përmendur në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni përfshin:

a) objektivat kombëtarë për vitet 2030, 2040 dhe 2050 në lidhje me normën vjetore të rinovimit, konsumin e energjisë primare dhe finale të stokut kombëtar të ndërtesave, si dhe reduktimet e emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit;

b) afate specifike kohore për ndërtesat jorezidenciale, që të jenë në përputhje me kufijtë më të ulët të performancës maksimale të energjisë sipas nenit 6 të këtij ligji, deri në vitin 2040 dhe 2050, në përputhje me rrugën për transformimin e stokut kombëtar të ndërtesave në ndërtesa pa emetime;

c) një vlerësim të bazuar në dëshmi të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera, duke përfshirë ato që lidhen me cilësinë e ambientit të brendshëm.

4. Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave hartohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe i nënshtrohet konsultimit publik sipas parashikimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Përpara miratimit dhe pas realizimit të konsultimit publik, një kopje e planit i dërgohet për opinion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

5. Opinioni i dhënë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) për Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave do të merret në konsideratë për t’u adresuar dhe ato rekomandime që nuk do të reflektohen, do të arsyetohen.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë, miraton Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, që përfshin të gjitha ndërtesat rezidenciale dhe jorezidenciale, publike dhe jopublike, me qëllim transformimin e tyre në ndërtesa me performancë të lartë energjetike dhe duke synuar dekarbonizimin e sektorit të ndërtesave deri në vitin 2050, me synim

transformimin e ndërtesave ekzistuese në ndërtesa pa emetime.

7. Plan i Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave rishikohet të paktën çdo pesë vjet. Çdo herë që plani rishikohet, si pjesë e anekseve të tij duhet të paraqiten detajet e zbatimit dhe implementimit të planit të mëparshëm, duke treguar nëse objektivat kombëtarë për atë diapazon kohor janë arritur.

Neni 6

Standardet minimale të performancës energjetike për ndërtesat jorezidenciale

1. Plan i Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave përcakton standarde minimale të performancës energjetike për ndërtesat jorezidenciale, të cilat sigurojnë që ato ndërtesa të mos e kalojnë prapun maksimal të specifikuar të performancës energjetike, të shprehur me një tregues numerik të përdorimit të energjisë primare ose përfundimtare në kWh/(m²·v), deri në datat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

2. Pragjet maksimale të performancës energjetike përcaktohen në bazë të stokut të ndërtesave jorezidenciale, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe, sipas rastit, në të dhënat statistikore.

3. Pragjet maksimale të performancës energjetike përcaktohen në Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave. Pragu i performancës energjetike mund të korrespondojë me një klas specifik të performancës energjetike.

4. Standardet minimale të performancës energjetike sigurojnë, të paktën, që të gjitha ndërtesat jorezidenciale të jenë më poshtë se:

- a) pragu prej 16% nga viti 2030;
- b) pragu prej 26% nga viti 2033.

Përputhshmëria e ndërtesave individuale jorezidenciale me pragjet kontrollohet në bazë të certifikatave të performancës energjetike ose, sipas rastit, mjeteve të tjera të disponueshme.

5. Në udhërrëfyesin e referuar në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 5 përcaktohen afate specifike kohore për ndërtesat jorezidenciale që të jenë në përputhje me pragjet më të ulëta të performancës maksimale energjetike deri në vitet 2040 dhe 2050, në përputhje me trajektoren për transformimin e stokut kombëtar të ndërtesave në ndërtesa pa emetime.

6. Ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban përcaktojnë dhe publikojnë kritere për të përjashtuar ndërtesat individuale jorezidenciale, duke pasur parasysh:

a) përdorimin e pritshëm të këtyre ndërtesave në të ardhmen;

b) vështirësitë e konsiderueshme për një ndërtesë ose tipologji ndërtesash;

c) ose në rastin e një vlerësimi të pafavorshëm kosto-përfitim, kërkesat në këtë pikë.

7. Çdo kriter sipas pikës 6 të këtij neni, duhet të jetë i mirëpërcaktuar dhe do të sigurojë trajtim të barabartë ndërmjet ndërtesave jorezidenciale.

8. Për përcaktimin e këtyre kritereve, institucioni përgjegjës do të realizojë vlerësimin *ex-ante* të pjesës së mundshme të ndërtesave jorezidenciale të mbuluara dhe do të shmangë përjashtimin e një numri joproporcional të ndërtesave jorezidenciale.

9. Kriteret e përcaktuara do të jenë pjesë e raportimeve të realizuara në kuadër të Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave të paraqitur tek SKE-ja në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

10. Pavarësisht vendosjes së kritereve për përjashtimin e ndërtesave në përputhje me pikën e mësipërme, duhet të garantohet arritja për përmirësime ekuivalente të performancës energjetike në pjesë të tjera të stokut të ndërtesave jorezidenciale.

11. Kur rinovimi i nevojshëm për arritjen e pragjeve të performancës energjetike të specifikuara në këtë nen ka një vlerësim të pafavorshëm kosto-përfitim për një ndërtesë të caktuar jorezidenciale, për atë ndërtesë të caktuar jorezidenciale zbatohen të paktën ato masa individuale rinovimi të cilat rezultojnë me një vlerësim të favorshëm kosto-përfitim.

12. Në rastin kur stoku kombëtar i ndërtesave jorezidenciale ose një pjesë e tij dëmtohet në mënyrë të konsiderueshme nga një fatkeqësi natyrore, ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban mund të rregullojë përkohësisht prapun maksimal të performancës energjetike në mënyrë që rinovimi energjetik i ndërtesave jorezidenciale të dëmtuara të zëvendësojë rinovimin energjetik të ndërtesave të tjera jorezidenciale me performancën më të ulët, ndërkohë që sigurohet që një përqindje e ngjashme e stokut të ndërtesave jorezidenciale t'i nënshtrohet



rinovimit energjetik. Pragu maksimal i performancës energjetike i përcaktuar dhe kohëzgjatja e tij raportohen në Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave.

13. Në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, mbështetja për zbatimin e standardeve minimale të performancës energjetike do të garantohet me të gjitha masat e mëposhtme:

a) sigurimin e masave të duhura financiare, veçanërisht ato që synojnë familjet e cenueshme, njerëzit e prekur nga varfëria energjetike ose, kur është e aplikueshme, që jetojnë në banesa sociale;

b) dhënien e asistencës teknike, duke përfshirë edhe këshillim dhe asistencë sipas nenit 31 të këtij ligji, me fokus të veçantë në familjet e cenueshme dhe, aty ku është e aplikueshme, njerëzit që jetojnë në banesa sociale;

c) hartimin e skemave të integruara të financimit, të cilat ofrojnë stimuj për rinovime të thelluara dhe rinovime të thelluara me faza;

ç) heqjen e barrierave joekonomike, duke përfshirë stimujt e ndarë;

d) monitorimin e ndikimeve sociale, veçanërisht në familjet më të cenueshme.

14. Çdo ndërtesë që rinovohet në mënyrë që të përputhet me standardet minimale të performancës energjetike duhet të sigurojë përputhjen me kërkesat minimale të performancës energjetike për elementet e ndërtesës në përputhje me nenin 9 të këtij ligji dhe, në rastin e rinovimit të konsiderueshëm, me kërkesat minimale për performancën energjetike për ndërtesat ekzistuese sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 7

Rinovimi progresiv i ndërtesave të banimit

1. Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave do të përcaktojë një trajektore kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit, në përputhje me udhërrëfyesin kombëtar dhe objektivat 2030, 2040 dhe 2050, me synim transformimin e stokut kombëtar të ndërtesave në një stok ndërtesash pa emetime deri në vitin 2050. Trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit do të përcaktohet si një zvogëlim i përdorimit mesatar të energjisë primare në kWh/(m²·v) për të gjithë stokun e ndërtesave të banimit gjatë periudhës 2025–2050 dhe do të identifikojë numrin e ndërtesave të banimit dhe njërive të ndërtesave të banimit ose

sipërfaqes së dyshemesë që do të mund të rinovohet çdo vit, duke përfshirë numrin ose sipërfaqen e dyshemesë së 43% të ndërtesave të banimit dhe njërive të ndërtesave të banimit me performancën energjetike më të ulët.

2. Trajektoreset për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit sigurojnë uljen e përdorimit mesatar të energjisë primare në kWh/(m²·v) nga stoku i ndërtesave të banimit dhe do të përcaktojnë përqindjet e zvogëlimit të përdorimit të energjisë primare në nivel kombëtar, në përputhje me synimin e transformimit të stokut të ndërtesave të banimit në një stok ndërtesash pa emetime.

3. Trajektoreset përgatiten me synimin që shumica e uljes së përdorimit mesatar të energjisë primare të arrihet nëpërmjet rinovimit të ndërtesës rezidenciale me performancën më të ulët.

4. Për të arritur uljen e kërkuar të përdorimit mesatar të energjisë primare të të gjithë stokut të ndërtesave të banimit do të përdoren masa të tilla si: standardet minimale të performancës energjetike sipas nenit 6 të këtij ligji, asistencë teknike dhe këshillim sipas nenit 31 të këtij ligji, dhe masa mbështetëse financiare në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, bazuar mbi parimin e kostos optimale.

5. Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave nuk përjashton në mënyrë disproporcionale ndërtesat e banimit ose njësitë e ndërtesave me qira.

6. Metodologjia e përdorur dhe të dhënat e mbledhura për vlerësimin e vlerave të përmendura sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, raportohen në Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave.

7. Trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit do t'u referohet të dhënave për stokun kombëtar të ndërtesave të banimit, bazuar, sipas rastit, në mostrat statistikore dhe certifikatat e performancës energjetike.

8. Përveç përdorimit të energjisë primare, të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, trajektoreset për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit mund të përcaktojnë tregues shtesë të përdorimit të energjisë primare jo të rinovueshme e të rinovueshme dhe të emetimeve operationale të gazeve serrë të prodhuara në kg CO₂ek/(m²·v).

9. Për të siguruar reduktimin e emetimeve operationale të gazeve serrë, standardet minimale të performancës energjetike duhet të marrin parasysh thjeshtimin dhe përsheptimin e procedurave administrative dhe përcaktimin e afateve kohore për procedurat e instalimit të burimeve të rinovueshme

në përputhje me ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.

KREU III
METODOLOGJITË E LLOGARITJES
DHE KËRKESAT E PERFORMANCËS
ENERGJETIKE

Neni 8

Metodologjia Kombëtare për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave

1. Performanca energjetike e një ndërtese përcaktohet në bazë të konsumit të llogaritur ose të matur të energjisë dhe pasqyron përdorimin tipik të energjisë për ngrohjen e ambienteve, ftohjen e ambienteve, ujin e ngrohtë sanitar, ventilimin, ndriçimin e integruar dhe sistemet e tjera teknike të ndërtesave.

2. Përdorimi tipik i energjisë është përfaqësues i kushteve aktuale të funksionimit për çdo tipologji përkatëse dhe pasqyron sjelljen tipike të përdoruesit. Kur është e mundur, përdorimi tipik i energjisë dhe sjellja tipike e përdoruesve bazohen në statistikën kombëtare të disponueshme, kodet e ndërtimit dhe në të dhënat e matura.

3. Kur konsumi i matur i energjisë është baza për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave, metodologjia e llogaritjes duhet të jetë në gjendje të identifikojë ndikimin e sjelljes së banorëve dhe klimës lokale, e cila nuk duhet të pasqyrohet në rezultatin e llogaritjes. Konsumi i matur i energjisë për qëllimin e llogaritjes së performancës energjetike të ndërtesave duhet të kërkojë lexime të paktën në intervale mujore dhe duhet të bëjë dallimin midis bartësve të energjisë.

4. Metodologjia Kombëtare për llogaritjen mund të përfshijë konsumin e matur të energjisë në kushte tipike përdorimi për të verifikuar saktësinë e konsumit të llogaritur të energjisë dhe për të mundësuar krahasimin midis performancës së llogaritur dhe asaj aktuale. Konsumi i matur i energjisë për qëllime verifikimi dhe krahasimi mund të bazohet në leximet mujore.

5. Performanca energjetike e një ndërtese shprehet me një tregues numerik të përdorimit të energjisë primare për njësi të sipërfaqes referuese të dyshemesë në vit, në kWh/(m²·v) për qëllime të certifikimit të performancës energjetike dhe përputhshmërisë me kërkesat minimale të

performancës energjetike. Metodologjia e aplikuar për përcaktimin e performancës energjetike të një ndërtese duhet të jetë transparente dhe e hapur ndaj risive.

6. Metodologjia Kombëtare për llogaritjen ndërtohet mbi bazën e standardeve kryesore evropiane për performancën energjetike të ndërtesave, përkatësisht SSH EN ISO 52000-1, SSH EN ISO 52003-1, SSH EN ISO 52010-1, SSH EN ISO 52016-1, SSH EN ISO 52018-1, SSH EN ISO 52120-1, SSH EN 16798-1 dhe SSH EN 17423 ose dokumente që i zëvendësojnë. Kjo dispozitë nuk përbën një kodifikim ligjor të këtyre standardeve.

7. Kur ndërtesat furnizohen nga sistemet e ngrohjes ose ftohjes qendrore, përfitimet e një furnizimi të tillë njihen dhe llogariten në metodologjinë e llogaritjes, në veçanti pjesa e energjisë së rinovueshme, nëpërmjet faktorëve të energjisë primare të miratuar.

8. Kërkesa për energji dhe konsumi i energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e ambienteve, ujin e ngrohtë sanitar, ventilimin, ndriçimin dhe sistemet e tjera teknike të ndërtesave llogariten duke përdorur intervalet e llogaritjes kohore mujore, orare ose nën-orare për të llogaritur kushtet e ndryshme që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në funksionimin dhe performancën e sistemit dhe në kushtet e brendshme dhe të optimizojë shëndetin, cilësinë e ajrit të brendshëm, duke përfshirë nivelet e komfortit, të përcaktuara në nivel kombëtar ose rajonal.

9. Në Metodologjinë Kombëtare për llogaritjen nuk përfshihet informacion shtesë, në rastet kur rregulloret specifike të produktit për produktet me ndikim në energji, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për projektimin ekologjik përfshijnë kërkesa specifike për informacionin e produktit për qëllimin e llogaritjes së performancës energjetike dhe PNG-së gjatë ciklit jetësor sipas këtij ligji.

10. Llogaritja e energjisë primare bazohet në faktorët e energjisë primare të përditësuar rregullisht dhe afatgjatë (duke diferencuar energjinë jo të rinovueshme, të rinovueshme dhe totale) ose në faktorët të ponderuar për bartës energjetik, të cilët njihen nga autoritetet kombëtare dhe duke marrë parasysh përzierjen e pritshme të energjisë në bazë të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Faktorët e energjisë primare ose faktorët e ponderuar mund të bazohen në informacione kombëtare, rajonale ose lokale. Faktorët e energjisë



primare ose faktorët e ponderuar mund të vendosen në baza vjetore, sezonale, mujore, ditore ose orare ose mbi informacione më specifike të disponueshme për sistemet e distrikteve individuale.

11. Faktorët e energjisë primare ose faktorët e ponderuar përcaktohen në Metodologjinë Kombëtare për Llogaritjen dhe zgjedhjet e bëra e burimet e të dhënave raportohen sipas standardeve evropiane SSH EN 17423 ose çdo dokumenti zëvendësues.

12. Me qëllim përcaktimin e performancës energjetike të një ndërtese, Metodologjia Kombëtare për Llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave do të përfshijë tregues numerikë shtesë të përdorimit të energjisë primare totale, jo të rinovueshme dhe të rinovueshme, dhe të emetimeve të gazeve serrë, të gjeneruara gjatë përdorimit, në $\text{kg CO}_2\text{ek}/(\text{m}^2\cdot\text{v})$.

13. Metodologjia për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave përfshin të paktën elementet e mëposhtme:

a) karakteristikat aktuale termike të ndërtesës, duke përfshirë ndarjet e brendshme të saj:

- i. kapacitetin termik;
- ii. izolimin termik;
- iii. ngrohjen pasive;
- iv. elementet ftohëse;
- v. nyjat termike.

b) sistemet për ngrohjen dhe furnizimin me ujë të ngrohtë sanitar, duke përfshirë karakteristikat e tyre sipas izolimit termik;

c) kapacitetin e instaluar në vendndodhje për prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe depozitimin e energjisë;

ç) sistemet për kondicionimin e ajrit;

d) sistemet e ventilimit mekanik dhe instalimet për ventilim natyror, të cilat mund të përfshijë shmangien e infiltrimeve të ajrit dhe rikuperimin e nxehtësisë;

dh) ndriçimin e integruar (kryesisht në sektorin jorezidencial);

e) projektimi, pozicionimi dhe orientimi i ndërtesës, duke përfshirë kushtet e jashtme klimatike;

ë) sistemet diellore pasive dhe sistemet për shmangien e rrezatimit diellor;

f) kushtet klimatike të brendshme, duke përfshirë klimën e brendshme të projektuar;

g) ngarkesat termike të brendshme;

gj) sistemet e automatizimit dhe kontrollit të ndërtesave dhe kapacitetet e tyre për të monitoruar, kontrolluar dhe optimizuar performancën energjetike.

14. Përveç sa më lart, merret parasysh edhe ndikimi pozitiv i aspekteve të mëposhtme:

a) kushtet lokale të ekspozimit diellor, sistemet diellore aktive dhe sistemet e tjera të ngrohjes dhe energjisë elektrike, në bazë të shfrytëzimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;

b) energjia elektrike e prodhuar nga kogjenerimi;

c) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qendrore (qytetase ose blloqe banimi);

ç) ndriçimi natyral;

d) sistemet e depozitimit të energjisë elektrike;

dh) sistemet e depozitimit të energjisë termike.

15. Për qëllime të llogaritjes së performancës energjetike, ndërtesat klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:

a) tipave të ndryshëm të shtëpive/ndërtesave ku banon vetëm një familje;

b) blloqeve të apartamenteve;

c) zyrave;

ç) ndërtesave të edukimit/arsimimit;

d) spitaleve;

dh) hoteleve dhe restoranteve;

e) objekteve sportive;

ë) ndërtesave ku zhvillohen aktivitete të tregtisë me shumicë ose pakicë që klasifikohen si ndërtesa shërbimi;

f) tipave të tjerë të ndërtesave që konsumojnë energji.

16. Metodologjia Kombëtare për Llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë.

Neni 9

Kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave

1. Kërkesat minimale të performancës energjetike për ndërtesat ose njësitë e ndërtesave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kanë si synim, të paktën, arritjen e nivelit të kostos optimale dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesa më të larta veçanërisht për ndërtesat pa emetime. Performanca energjetike llogaritet në përputhje me metodologjinë e specifikuar në nenin 8 të këtij ligji. Nivelet e kostos optimale llogariten në



përputhje me kornizën metodologjike krahasuese, të përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kërkesat minimale për:

a) performancën energjetike të ndërtesave të reja dhe të njësive të ndërtesave të reja, si dhe ndërtesave ekzistuese e të njësive të ndërtesave ekzistuese që do t'i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm;

b) elementet e ndërtesës që përbëjnë pjesë të mbështjellësës së ndërtesës dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjetike të mbështjellësës së ndërtesës kur ato rinovohen ose zëvendësohen;

c) sistemet teknike të ndërtesave, kur ato instalohen, zëvendësohen ose përmirësohen;

ç) kushtet e ambientit të brendshëm të ndërtesave për të garantuar kushtet e komfortit dhe mirëqenies për përdoruesit.

3. Kërkesat minimale të performancës energjetike vendosen për elementet e ndërtesës që përbëjnë pjesë të mbështjellësës së ndërtesës dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjetike të mbështjellësës së ndërtesës kur ato zëvendësohen ose riparohen, me qëllim për të arritur të paktën nivelin e kostos optimale. Kërkesat minimale për performancën energjetike hartohen që të përfshijnë elementet e ndërtimit në atë nivel që do të lehtësonte instalimin efektiv të sistemeve të ngrohjes me temperaturë të ulët në ndërtesat e rinovuara.

4. Kërkesat minimale të performancës energjetike marrin parasysh cilësinë optimale të ambientit të brendshëm, në mënyrë që të shmangen efektet e mundshme negative si ventilim i pamjaftueshëm, kushtet lokale të komfortit, funksionin dhe aktivitetin e ndërtesës, si dhe vjetërsinë e ndërtesës.

5. Kërkesat minimale të performancës energjetike rishikohen të paktën çdo pesë vjet dhe, nëse është e nevojshme, përditësohen në mënyrë që të pasqyrojnë progresin teknik në sektorin e ndërtimit, rezultatet e llogaritjes së kostos optimale, të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, objektivat dhe politikat e përditësuara kombëtare të energjisë dhe klimës.

6. Kategoritë e ndërtesave, që përjashtohen nga detyrimet për zbatimin e kërkesave minimale për performancën energjetike në ndërtesa, miratohen në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 10

Llogaritja e nivelit të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave

1. Niveli i kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjetike llogaritet duke përdorur metodologjinë krahasuese për përcaktimin e nivelit të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjetike për ndërtesat dhe elementet e ndërtesave.

2. Llogaritja e nivelit optimal të kostos për kërkesat minimale të performancës energjetike realizohet duke përdorur metodologjinë sipas pikës 1 të këtij neni dhe parametra të tjerë si kushtet klimatike dhe aksesueshmëria e infrastrukturës energjetike. Rezultatet e llogaritjes krahasohen me kërkesat minimale të performancës energjetike në fuqi.

3. Rezultatet e llogaritjes së kostos optimale sipas procedurës së mësipërme pasqyrohen në raportin kombëtar të kostos optimale dhe bëhen publike për të gjitha palët e interesuara nga ministria përgjegjëse për energjinë.

4. Të gjitha të dhënat hyrëse dhe supozimet e përdorura për llogaritjet e niveleve të kostos optimale të kërkesave minimale të performancës energjetike dhe rezultatet e këtyre llogaritjeve raportohen te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Formatit për raportim miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

5. Nëse rezultati i krahasimit të kryer në përputhje me pikën 2 të këtij neni tregon se kërkesat minimale të performancës energjetike në fuqi janë më pak eficiente në konsumin energjetik sesa nivelet e kostos optimale të kërkesave të performancës minimale të energjisë me më shumë se 15 %, kërkesat minimale të performancës energjetike do të rishikohen brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga disponueshmëria e rezultateve të krahasimit.

6. Metodologjia sipas pikës 1 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ndër të tjera:

a) përcakton ndërtesat referente që karakterizohen dhe përfaqësojnë funksionalitetin dhe vendndodhjen e tyre gjeografike, duke përfshirë kushtet klimatike të brendshme dhe të jashtme. Ndërtesat referuese duhet të mbulojnë ndërtesat e



banimit dhe ato jorezidenciale, qofshin ato të reja apo ekzistuese;

b) përcakton masat e eficiencës energjetike që do të vlerësohen për ndërtesat referente. Këto mund të jenë masa për ndërtesa individuale në tërësi, për elemente të veçanta ndërtimi ose për një kombinim të elementeve të ndërtimit;

c) vlerëson nevojën për energji finale e primare, si dhe emetimet rezultuese të ndërtesave referente me masat e përcaktuara të eficiencës energjetike kur ato aplikohen;

ç) llogarit kostot (vlerën aktuale neto “NPV”) e masave të eficiencës së energjisë, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, gjatë ciklit të pritshëm të jetës ekonomike të aplikuar për ndërtesat referente, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, duke zbatuar parimet e kuadrit të metodologjisë krahasuese.

KREU IV DETYRIMET DHE CERTIFIKATAT E PERFORMANCËS ENERGJETIKE PËR NDËRTESAT

Neni 11 Ndërtesat pa emetime

1. Ndërtesat pa emetime janë ato ndërtesa të cilat gjatë përdorimit nuk çlirojnë asnjë gaz me efekt serrë në vendndodhje nga lëndët djegëse fosile dhe, kur është e mundur, nga pikëpamja ekonomike e teknike zotërojnë kapacitetin e nevojshëm për të reaguar ndaj sinjaleve të jashtme për të përshtatur përdorimin, prodhimin dhe depozitimin e energjisë.

2. Ndërtesat pa emetime:

a) kanë një kërkesë për energji më të vogël se kërkesa e përcaktuar në $\text{kWh}/(\text{m}^2 \cdot \text{v})$ në vendimin e Këshillit të Ministrave, që përcakton procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjetike të ndërtesave;

b) kërkesa për energji sipas shkronjës “a” përkon të paktën me arritjen e nivelit të kostos optimale dhe do të ndryshojë sa herë që niveli i kostos optimale rillogaritet përmes raportit kombëtar të kostos optimale;

c) kërkesa për energji mund të reduktohet më tej në varësi të rezultateve të raportit kombëtar të kostos optimale. Kërkesa për energji sipas shkronjës “a” përkon të paktën me arritjen e nivelit të kostos optimale dhe do të ndryshojë sa herë që niveli i

kostos optimale rillogaritet përmes raportit kombëtar të kostos optimale.

3. Pragu maksimal i emetimeve të gazeve me efekt serrë për operimin e ndërtesave pa emetime përcaktohet në Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave dhe përfshin tregues për ndërtesat e reja dhe ato që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

4. Pragjet maksimale, përfshirë edhe një përshkrim të metodologjisë së llogaritjes në varësi të tipologjisë së ndërtesës dhe kushteve të jashtme klimatike, i raportohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

5. Energjia totale primare që përdoret nga një ndërtesë pa emetime, e re ose e rinovuar mbulohet nga:

a) energjia e gjeneruar nga burime të rinovueshme të prodhuara në vendndodhje, pranë ndërtesës ose nga një komunitet i energjive të rinovueshme, duke përmbushur kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;

b) energjia e gjeneruar nga një sistem alternativ me eficiencë të lartë për ngrohjen dhe ftohjen;

c) energjia e gjeneruar nga burime që nuk përmbajnë karbon.

6. Kur nuk është e mundur nga pikëpamja teknike dhe ekonomike për të përmbushur kriteret e vendosura në pikën 5 të këtij neni, energjia primare totale mund të mbulohet gjithashtu nga energjia elektrike e rrjetit elektroenergetik kombëtar.

Neni 12 Detyrimet për ndërtesat e reja

1. Të gjitha ndërtesat e reja, që do të ndërtohen nga 1 janari 2030, do të jenë ndërtesa pa emetime në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Deri në zbatimin e kërkesave sipas kësaj pike, të gjitha ndërtesat e reja plotësojnë ose tejkalojnë kërkesat minimale të performancës energjetike, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 9 të këtij ligji.

2. PNG-ja gjatë ciklit jetësor është një tregues numerik i llogaritur në përputhje me metodologjinë e hartuar sipas pikës 3 të këtij neni dhe përfshihet në certifikatën e performancës energjetike të ndërtesës:

a) nga 1 janari 2028 për të gjitha ndërtesat e reja me sipërfaqe të dobishme më të madhe se $1\,000\text{ m}^2$;

b) nga 1 janari 2030 për të gjitha ndërtesat e reja.



3. Metodologjia Kombëtare për Llogaritjen e PNG-së gjatë ciklit jetësor për ndërtesat e reja miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

4. Parashikimet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për ndërtesat për të cilat kërkesa për leje ndërtimi ose aplikime ekuivalente, duke përfshirë ndryshimin e përdorimit, janë realizuar deri në datat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Deri më 1 janar 2029, ministria përgjegjëse për energjinë do të publikojë dhe do të dërgojë te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë një udhërrëfyes që detajon prezantimin e vlerave të lejuara të PNG-së totale kumulative të ciklit jetësor të të gjitha ndërtesave të reja dhe vendos objektiva për ndërtesat e reja nga viti 2030, duke marrë parasysh një tendencë në rënie progresive, si dhe vlerat maksimale të lejuara, të detajuara për zona të ndryshme klimatike dhe tipologji të ndryshme ndërtesash. Vlerat maksimale të lejuara do të jenë në përputhje me objektivin për arritjen e neutralitetit klimatik.

6. Të gjitha ndërtesat e reja përfshijnë në fazën e projektimit, aplikimit për leje ndërtimi dhe aplikimit për leje shfrytëzimi të gjithë dokumentacionin, projektin dhe informacionin e nevojshëm që vërteton adresimin e çështjeve të mëposhtme:

- a) cilësinë e ambientit të brendshëm në ndërtesa;
- b) adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike;
- c) mbrojtjen nga zjarri;
- ç) sigurinë sizmike;
- d) aksesueshmërinë në ndërtesë për personat me aftësi të kufizuara;

dh) infrastrukturën e brendshme digjitale në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, miraton rregullat dhe kriteret për zhvillimin dhe ndërtimin e objekteve sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 13

Detyrimet për ndërtesat ekzistuese

1. Ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, plotësojnë të paktën kërkesat minimale të performancës energjetike, të përcaktuara në përputhje me nenin 9 të këtij ligji, në tërësi ose për

elementet që i nënshtrohen rinovimit për aq sa janë teknikisht, funksionalisht të realizueshme dhe ekonomikisht në përputhje me nivelet e koston optimale.

2. Kur një element ndërtimi, që është pjesë e mbështjelljes së ndërtesës ose njësisë së ndërtesës dhe ka një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjetike të mbështjelljes së ndërtesës, riparohet ose zëvendësohet, elementi i ndërtimit duhet të plotësojë kërkesat minimale të performancës energjetike për aq sa është teknikisht, funksionalisht e realizueshme dhe ekonomikisht në përputhje me nivelet e koston optimale.

3. Për ndërtesat, që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, subjektet zhvilluese duhet të garantojnë:

- a) cilësinë e ambienteve të brendshme sipas kërkesave minimale të performancës energjetike;
- b) zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë burime fosile kur sistemi teknik do t'i nënshtrohet rinovimit;
- c) përshtatshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike;
- ç) mbrojtjen nga zjarri;
- d) sigurinë sizmike;
- dh) largimin e substancave të rrezikshme;
- e) aksesueshmërinë në ndërtesë për personat me aftësi të kufizuara.

4. Për ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, që do t'i nënshtrohen një ndërhyrjeje që klasifikohet si rinovim i konsiderueshëm sipas këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore garantojnë plotësimin e kërkesave të këtij neni për ndërhyrje që kërkojnë pajisjen me deklaratë paraprake:

- a) ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energjetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese;
- b) riparimi dhe zëvendësimi i dritareve e i dyerve, qepenave dhe vitrinave;
- c) zëvendësimi, riparimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë;
- ç) riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
- d) riparimi dhe rinovimi i dyshemesë në kontakt me tokën ose në kontakt me hapësira të pakondicionuara;

dh) zëvendësimi i sistemeve të ujit të ngrohtë sanitar dhe të sistemeve të ngrohjes/ftohjes së ndërtesave;

e) instalimi i sistemeve që shfrytëzojnë energjinë e rinovueshme në ndërtesë ose pranë ndërtesës.



Neni 14

Infrastruktura për lëvizshmëri të qëndrueshme

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërtesat e reja jorezidenciale me më shumë se pesë vende parkimi makinash dhe ndërtesat jorezidenciale, që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se pesë vende parkimi makinash duhet të projektojnë dhe të ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për:

a) instalimin e të paktën 1 (një) stacioni karikimi për çdo 5 (pesë) vendpushime makinash;

b) instalimin e sistemeve dhe tubacioneve të nevojshme për çdo vendpushim makinash për të mundësuar më vonë lidhjen e stacioneve të karikimit për çdo vendpushim;

c) garantimin e hapësirave për pushimin e biçikletave, duke marrë parasysh hapësirën e kërkuar edhe për biçikletat me dimensione më të mëdha se biçikletat standarde, të paktën 2 (dy) vendpushime për çdo njësi rezidenciale.

2. Instalimi i sistemeve të nevojshme të përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni dimensionohet në mënyrë që ato të mundësojnë përdorimin e njëkohshëm dhe eficient të numrit të kërkuar të stacioneve të karikimit dhe të mbështesin, sipas rastit, instalimin e një sistemi të menaxhimit të ngarkesës ose karikimit në masën që kjo është teknikisht e ekonomikisht e realizueshme dhe e justifikueshme.

3. Me përjashtim të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, për ndërtesat e reja të zyrave dhe ndërtesat ekzistuese të zyrave që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se dy vendpushime makinash, subjektet zhvilluese sigurojnë instalimin e të paktën një stacioni karikimi për çdo dy vende parkimi.

4. Parashikimet sipas pikës 1 të këtij neni zbatohen kur:

a) vendpushimi është i pozicionuar në brendësi të ndërtesës dhe për rinovime të konsiderueshme rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës;

b) vendpushimi është fizikisht pranë ose ngjitur me ndërtesën dhe për rinovime të konsiderueshme rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës.

5. Ndërtesat e reja të banimit dhe ndërtesat e banimit, që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se tre vendpushime makinash, duhet të projektojnë dhe të ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për:

a) instalimin e sistemeve të nevojshme për çdo vendpushim makinash për të mundësuar më vonë lidhjen e stacioneve të karikimit për çdo vendpushim;

b) garantimin e hapësirave për pushimin e biçikletave, duke marrë parasysh hapësirën e kërkuar edhe për biçikletat me dimensione më të mëdha se biçikletat standarde, të paktën 2 (dy) vendpushime për çdo njësi banimi.

6. Parashikimet sipas pikës 5 të këtij neni zbatohen kur:

a) vendpushimi është i pozicionuar në brendësi të ndërtesës dhe për rinovime të konsiderueshme rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës;

b) vendpushimi është fizikisht pranë ose ngjitur me ndërtesën dhe në rastin e rinovimeve të konsiderueshme rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për infrastrukturën, miraton vendimin për përcaktimin e kërkesave, kritereve, kushteve dhe procedurave për instalimin e infrastrukturës së qëndrueshme në ndërtesa.

Neni 15

Certifikata e performancës energjetike

1. Certifikatat e performancës energjetike gjenerohen përmes programeve kompjuterike të miratuara, që funksionojnë mbi bazën e metodologjisë për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

2. Programet kompjuterike për gjenerimin e certifikatave të performancës energjetike miratohen nga ministria përgjegjëse për energjinë.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë garanton për të paktën një program kompjuterik aksesimin dhe përdorimin pa kosto për të gjithë palët e interesuara.



4. Certifikatat e performancës energjetike përdorin shkallën nga A+ në G për të diferencuar ndërtesat në varësi të konsumit të tyre energjetik. Klasi A+ korrespondon me një ndërtesë me pragun maksimal të kërkesës për energji, i cili është të paktën 20% më i ulët se kufiri maksimal për ndërtesat pa emetime dhe që gjeneron energji të rinovueshme në vendndodhje çdo vit, jo më pak se kërkesa totale vjetore për energji primare.

5. Certifikatat e performancës energjetike përfshijnë rekomandime për përmirësimin e performancës energjetike, në përputhje me nivelin e kostos optimale, reduktimin e emetimeve gjatë përdorimit tipik të ndërtesës dhe përmirësimin e cilësisë së ambientit të brendshëm.

6. Kërkesat sipas pikës 5 të këtij neni nuk aplikohen për ndërtesat që klasifikohen në klasin energjetik A dhe A+.

7. Rekomandimet që përfshihen në certifikatën e performancës energjetike do të përfshijnë:

a) masat e eficiencës në lidhje me një rinovim të konsiderueshëm të mbështjellësës së ndërtesës ose të sistemit/eve teknike të ndërtesës;

b) masat e eficiencës për elemente të veçanta të mbështjellësës së ndërtesës ose të sistemit/eve teknike të ndërtesës, që nuk klasifikohen si një rinovim i konsiderueshëm.

8. Kur certifikata e performancës energjetike shoqërohet me librezën e rinovimit, rekomandimet sipas pikës 7 të këtij neni përfshihen vetëm në librezën e rinovimit.

9. Rekomandimet e përfshira në certifikatën e performancës energjetike janë teknikisht të realizueshme për ndërtesën specifike dhe ofrojnë një vlerësim për kursimet e energjisë, si dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit të ndërtesës. Çdo rekomandim shoqërohet me një vlerësim të periudhës së vetëshlyerjes gjatë gjithë ciklit jetësor të investimit, me një informacion për stimujt financiarë të disponueshëm, ndihmën administrative e teknike, si dhe me përfitimet financiare që lidhen me arritjen e vlerave referente.

10. Rekomandimet përfshijnë një vlerësim nëse sistemet e ngrohjes, sistemet e ventilimit, sistemet e ajrit të kondicionuar dhe sistemet e ujit të ngrohtë sanitar mund të përshtaten për të funksionuar në një temperaturë që rrit eficiencën.

11. Rekomandimet përfshijnë një vlerësim të jetëgjatësisë së mbetur të sistemit të ngrohjes ose sistemit të kondicionimit të ajrit. Aty ku është e

përshtatshme, rekomandimet do të tregojnë alternativat e mundshme për zëvendësimin e sistemit të ngrohjes ose të sistemit të kondicionimit të ajrit, në përputhje me objektivat klimatike 2030 dhe 2050, duke marrë parasysh kushtet lokale dhe mundësitë e lidhura me sistemin.

12. Certifikata e performancës energjetike tregon se ku pronari ose qiramarrësi i ndërtesës ose njësisë së ndërtesës mund të marrë informacion më të detajuar, duke përfshirë kosto-efektivitetin e rekomandimeve të bëra në certifikatën e performancës energjetike. Vlerësimi i efektivitetit të kostos do të bazohet në një sërë kushtesh standarde, të tilla si vlerësimi i kursimeve të energjisë dhe çmimet themelore të energjisë dhe një parashikim paraprak i kostos. Përveç kësaj, ai do të përmbajë informacion mbi hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve, informacionin e kontaktit të sporteleve me një ndalesë dhe, aty ku është e nevojshme, për opsionet e mbështetjes financiare. Informacione të tjera për tema të ndërlidhura, të tilla si auditimet e energjisë ose stimujt e një natyre financiare ose të tjera dhe mundësitë financiare, ose këshilla se si të rritet qëndrueshmëria klimatike e ndërtesës, mund t'i jepet gjithashtu pronarit ose qiramarrësit të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës.

13. Certifikata e performancës energjetike është e vlefshme për 10 (dhjetë) vjet nga momenti i lëshimit për ndërtesat e përfunduara.

14. Për ndërtesat në fazë projekti, certifikata paraprake e performancës energjetike është e vlefshme deri në përfundimin e punimeve dhe e humbet vlefshmërinë para fillimit të procesit të kolaudimit të ndërtesës.

15. Kur një ndërtesë i është lëshuar një certifikatë e performancës energjetike nën nivelin C, pronarët e ndërtesave ftohen në një sportel me një ndalesë për të marrë këshilla rinovimi për cilëndo nga arsyet e mëposhtme që plotësohet më parë:

a) menjëherë pas skadimit të certifikatës së performancës energjetike të ndërtesës; ose

b) pesë vjet pas lëshimit të certifikatës së performancës energjetike.

16. Përditësimi i certifikatave të performancës energjetike realizohet përmes programeve kompjuterike të miratuara, pas çdo rekomandimi të zbatuar në përputhje me librezën e rinovimit.

17. Të dhënat kryesore që përfshihen në certifikatën e performancës energjetike janë:



- a) klasi i performancës energjetike;
- b) një tregues numerik i energjisë primare të përdorur në kWh/(m²·v);
- c) një tregues numerik i energjisë finale të përdorur në kWh/(m²·v);
- ç) energjia e rinovueshme e gjeneruar në vendndodhje në përqindje të energjisë së përdorur;
- d) gazet me efekt serrë operationale në kgCO₂/(m²·y)
- dh) treguesit për ndërtesat “gati për GIGABIT”.

18. Procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjetike të ndërtesave e modeli, përmbajtja dhe të dhënat e tjera informuese e plotësuese që përfshihen në “Certifikatën e performancës energjetike” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe ministrisë përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 16

Lëshimi i certifikatës së performancës energjetike

1. Certifikimi i performancës energjetike është i detyrueshëm për:

- a) të gjitha ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, të cilat do të shiten ose do të jepen me qira;
- b) të gjitha ndërtesat, të cilat do të projektohen, do të ndërtohen ose do t'i nënshtrohen rinovimit të konsiderueshëm;
- c) të gjitha ndërtesat që janë në përdorim nga një institucion publik.

2. Certifikata e performancës energjetike bëhet e disponueshme vetëm në format digjital dhe është lehtësisht e printueshme nga pronarët e ndërtesave.

3. Detyrimet sipas pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për ndërtesat që disponojnë një certifikatë të performancës energjetike brenda periudhës së vlefshmërisë.

4. Detyrimet sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni do të zbatohen vetëm pas miratimit të skemës së librezave të rinovimit sipas nenit 21 të këtij ligji.

5. Kur ndërtesat ose njësitë e ndërtesave janë ndërtuar, kanë pësuar një rinovim të konsiderueshëm ose kur rinovohen kontratat e qirasë për ndërtesat ose njësitë e ndërtimit, certifikata e performancës energjetike i tregohet kandidatit qiramarrës ose blerës dhe i dorëzohet blerësit ose qiramarrësit.

6. Kur një ndërtesë shitet ose jepet me qira përpara ndërtimit ose rinovimit të konsiderueshëm, shitësit vendosin në dispozicion certifikatën e performancës energjetike paraprake, e cila jep një vlerësim të performancës së ardhshme energjetike të ndërtesës. Në çdo rast, certifikata e performancës energjetike do të lëshohet pasi ndërtesa të jetë ndërtuar ose rinovuar dhe duhet të pasqyrojë rendimentin energjetik sipas gjendjes së ndërtuar.

7. Njësitë e ndërtesave që ofrohen për shitje ose me qira duhet të pajisen me certifikatën e performancës energjetike dhe treguesi i performancës energjetike dhe klasa e certifikatës së performancës energjetike të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës, sipas rastit, deklarohen në reklamën *on-line* dhe *off-line*, duke përfshirë faqet e internetit të portalit të kërkimit të pronës.

8. Certifikatat e performancës energjetike lëshohen, ngarkohen dhe regjistrohen në bazën e të dhënave, pa asnjë kosto shtesë.

9. Certifikatat e performancës energjetike, të lëshuara nga audituesit energjetikë në ndërtesa, ngarkohen nga këto të fundit në bazën e të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave të përmendura në nenin 29 të këtij ligji. Ngarkimi duhet të përmbajë certifikatën e plotë të performancës energjetike, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përdorur për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesës.

10. Certifikata e performancës energjetike është pjesë e dokumenteve të nevojshëm për realizimin e kontratës së shitjes ose dhënies me qira.

Neni 17

Shfaqja e certifikatave të performancës energjetike

1. Institucionet publike, të cilat kanë në pronësi apo përdorim ndërtesa, të cilat janë të pajisura me certifikatën e performancës energjetike, janë të detyruara ta shfaqin atë në një vend të dukshëm për publikun.

2. Pronarët, të cilët kanë në pronësi ndërtesa jorezidenciale, të cilat janë të pajisura me certifikatën e performancës energjetike, janë të detyruara ta shfaqin atë në një vend të dukshëm për punonjësit dhe vizitorët.

3. Dispozitat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni përfshijnë vetëm detyrimin për të paraqitur klasin



energjetik të ndërtesës, e cila gjendet në certifikatën e performancës energjetike.

KREU V SISTEMET TEKNIKE NË NDËRTESA

Neni 18

Shfrytëzimi i energjisë diellore në ndërtesa

1. Duke nisur nga viti 2026, të gjitha ndërtesat e reja projektohen duke optimizuar potencialin e tyre të shfrytëzimit të energjisë diellore në bazë të rrezatimit diellor të zonës dhe duke mundësuar instalimin e mëvonshëm me kosto efektive të teknologjive diellore.

2. Procedura për dhënien e lejeve të nevojshme për instalimin e sistemeve diellore do të funksionojë sipas ligjit përkatës për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për impiantet që gjenerojnë energji elektrike dhe energji termike.

3. Me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për planifikimin e zhvillimit të territorit, Këshilli i Ministrave miraton një skemë kombëtare për instalimin në ndërtesa të sistemeve që shfrytëzojnë energjinë diellore, e cila përfshin rregulla lehtësuese për realizimin e instalimeve, bazuar edhe në analizën e ndikimit të shtimit të gjenerimit nga kapacitete fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes.

4. Skema e sipërpërmendur do të aplikohet për çdo ndërtesë që plotëson kushtet e përshtatshmërisë dhe zbatueshmërisë së saj, nga pikëpamja teknike, ekonomike (kosto përfitim), funksionale dhe e ndikimit në rrjet.

5. Skema sipas pikës 3 të këtij neni do të përfshijë:

a) nga data 31 dhjetor 2028 të gjitha ndërtesat e reja publike dhe ndërtesat jorezidenciale, me një sipërfaqe të dobishme më të madhe se 250 m²;

b) të gjitha ndërtesat publike ekzistuese, me sipërfaqe të dobishme më të madhe se:

i. 2000 m² nga data 31 dhjetor 2028;

ii. 750 m² nga data 31 dhjetor 2029;

iii. 250 m² nga data 31 dhjetor 2030;

c) nga data 31 dhjetor 2029 ndërtesat ekzistuese jorezidenciale, me sipërfaqe të dobishme më të madhe se 500 m², ku ndërtesa i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm ose një veprimi që kërkon një leje administrative për rinovimin e ndërtesës, përfshirë punimet në çati ose instalimin e sistemeve teknike;

ç) nga data 31 dhjetor 2029 ndërtesat e reja rezidenciale; dhe

d) nga data 31 dhjetor 2029 vendpushimet e reja të mbuluara për mjete lëvizëse, të pozicionuara fizikisht pranë me ndërtesat.

6. Vendimi sipas pikës 3 të këtij neni, do të përfshijë kriteret specifike që duhet të plotësojnë ndërtesat për të qenë pjesë e kësaj skeme, si dhe ndërtesat që përjashtohen sipas aktivitetit dhe funksionit të tyre.

7. Skema përfshin të gjitha masat e nevojshme administrative dhe teknike për të mbështetur dhe për të lehtësuar instalimin e sistemeve që shfrytëzojnë energjinë diellore, duke përfshirë dhe mundësitë për kombinimin e këtyre teknologjive me sistemet teknike ekzistuese në ndërtesa, si dhe me sistemet e ngrohjes e ftohjes qendrore.

Neni 19

Sistemet teknike në ndërtesa

1. Kërkesat minimale për performancën energjetike në ndërtesa sipas nenit 9 të këtij ligji përfshijnë kërkesa specifike për eficiencën e sistemeve teknike që përdoren në ndërtesa të reja dhe në ndërtesa që do t'i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

2. Kërkesat specifike zbatohen për rinovimin, përmirësimin ose zëvendësimin e sistemeve teknike ose pjesëve të sistemeve teknike që përdoren në ndërtesa dhe janë të paktën në përputhje me nivelet e kostos optimale, sipas raportit më të fundit.

3. Kërkesat për sistemet teknike në ndërtesa përfshijnë të paktën:

a) zbatimin e standardeve për garantimin e cilësisë së ambientit të brendshëm me qëllim ruajtjen e mirëqenies së përdoruesve të ndërtesës;

b) instalimin e aparaturave për matjen, kontrollin, monitorimin dhe rregullimin e cilësisë së ajrit të brendshëm për ndërtesat pa emetime jorezidenciale. Në ndërtesa jorezidenciale ekzistuese instalimi i këtyre aparaturave do të jetë i detyrueshëm kur ndërtesa i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm dhe është i zbatueshëm nga pikëpamja teknike dhe ekonomike;

c) kushtet për instalimin e sistemeve atutomatike të ndriçimit;

ç) kërkesa të tjera specifike sipas tipologjisë së ndërtesës.



4. Instalimet e sistemeve teknike ose ndryshimet e bëra në sistemet teknike duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të performancës energjetike. Rezultatet e këtij vlerësimi duhet t'i vihen në dispozicion pronarit të ndërtesës dhe të ngarkohen në bazën e të dhënave për performancën energjetike.

5. Nxitja e sistemeve teknike me eficiencë të lartë realizohet nëpërmjet skemave mbështetëse të cilat hartohen nga ministri përgjegjës për energjinë, bazuar në parimet teknike, ekonomike (kosto përfitim) dhe funksionale dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Skema sipas pikës 5 të këtij neni konsideron të paktën sistemet:

- a) alternative me eficiencë të lartë energjie, sipas nenit 20 të këtij ligji;
- b) për ngrohjen dhe kondicionimin e ajrit;
- c) e kontrollit dhe të automatizimit;
- ç) e ujit të ngrohtë sanitar;
- d) e ndriçimit;
- dh) e karikimit të makinave;
- e) e depozitimit të energjive të rinovueshme në ndërtesa.

7. Skema ka si synim kryesor zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë energjinë e përftuar nga burime jo të rinovueshme energjie, si dhe aplikimin e teknologjive me eficiencë të lartë energjie në plotësimin e kërkesave minimale të komfortit dhe cilësisë së ambientit të brendshëm.

Neni 20

Sistemet teknike alternative me eficiencë të lartë energjetike

1. Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, subjekti zhvillues konsideron aplikimin e sistemeve me performancë të lartë energjetike, si më poshtë:

- a) sistemet e decentralizuara të furnizimit me energji që shfrytëzojnë burime të rinovueshme të energjisë;
- b) sistemet kogjeneruese, që realizojnë prodhimin e kombinuar të energjisë termike dhe të energjisë elektrike ose mekanike;
- c) sistemet me pompa nxehtësie, të cilat ndryshojnë dhe transferojnë rrjedhën natyrale të energjisë termike nga ambienti i jashtëm të ndërtesat ose njësitë e ndërtesave dhe anasjelltas, nëse kërkohet një gjë e tillë;

ç) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes së përqendruar, veçanërisht ato që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie për ndërtesa ose blloqe ndërtesash.

2. Nëse aplikimi për leje ndërtimi/punimesh/administrative përfshin vetëm zëvendësimin ose rinovimin e sistemit teknik të ndërtesës, paraprakisht duhet të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficiencë të lartë energjie, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Dëshmitë e vlerësimit të zbatueshmërisë së përdorimit të sistemeve alternative të sipërpërmendura shoqërojnë certifikatën e performancës energjetike për çdo ndërtesë, ngarkohen në bazën e të dhënave sipas nenit 29 të këtij ligji dhe janë të disponueshme për inspektim.

4. Forma dhe përmbajtja e dëshmive të vlerësimit të zbatueshmërisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficiencë të lartë energjetike miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë, me propozimin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.

5. Nëse analiza e mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficiencë të lartë energjie nuk kryhet nga pronari i ndërtesës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, atëherë duhet të zbatohen masat administrative në përputhje me parashikimet e nenit 33 të këtij ligji.

Neni 21

Libreza e rinovimit të ndërtesës

1. Libreza e rinovimit të ndërtesave u mundëson pronarëve të ndërtesave një pasqyrë gjithëpërfshirëse për mundësitë, hapat dhe informacionin e nevojshëm për të realizuar një rinovim të thelluar, me qëllim rritjen e performancës energjetike të ndërtesës, duke synuar tjetërsimin në një ndërtesë pa emetime dhe me konsum energjetik pothuajse zero.

2. Libreza e rinovimit është e detyrueshme për çdo ndërtesë ekzistuese që do t'i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm dhe lëshohet nga audituesit energjetikë në ndërtesa së bashku me certifikatën e performancës energjetike, në formë digjitale të përshtatshme për printim.

3. Libreza e rinovimit të ndërtesës përfshin të gjithë hapat e nevojshëm për transformimin e ndërtesës ekzistuese në një ndërtesë pa emetime.



4. Libreza e rinovimit të ndërtesës ngarkohet nga audituesit energjetikë në ndërtesa në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave, të ngritur në përputhje me nenin 29 të këtij ligji, e cila mund të aksesohet lehtësisht nga palët e interesuara.

5. Rregullat për lëshimin e librezave propozohen nga ministri përgjegjës për energjinë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe do të përcaktojnë formën, kushtet, kriteret, informacionin dhe të dhëna të tjera që librezat për rinovimin e ndërtesës duhet të përmbajë.

Neni 22

Vlerësimi i sistemeve teknike

1. Duke filluar nga 1 janari 2027, sistemet teknike në ndërtesa do të vlerësohen në intervale të caktuara dhe do të përfshijnë sistemet e ngrohjes, sistemet e ventilimit dhe sistemet e kondicionimit të ajrit, duke përfshirë çdo kombinim të tyre, me një fuqi nominale efektive mbi 70 kW. Vlerësimi efektiv i sistemit do të bazohet në shumën e prodhimit të vlerësuar të gjeneratorëve të nxehtësisë dhe impianteve ftohës.

2. Sistemet teknike sipas pikës 1 të këtij neni vlerësohen të paktën çdo tre vjet, ndërsa sistemet me gjeneratorë nxehtësie ose impiante ftohës, me fuqi nominale efektive më shumë se 290 kW do të vlerësohen të paktën çdo 2 (dy) vjet.

3. Vlerësimi dhe raportimi i sistemeve teknike realizohet vetëm nga audituesit energjetikë në procese industriale të certifikuar sipas ligjit përkatës për eficiencën energjetike dhe vlerësuesit e sistemeve teknike të certifikuar sipas këtij ligji.

4. Vlerësimi përfshin këqyrjen e gjeneratorit ose gjeneratorëve, pompave të qarkullimit dhe, sipas rastit, përbërësve të sistemeve të ventilimit, sistemeve të shpërndarjes së ajrit dhe ujit, sistemeve të balancimit hidronik dhe sistemeve të kontrollit.

5. Vlerësimi duhet të përfshijë një analizë të eficiencës energjetike dhe përmasimit të gjeneratorit ose gjeneratorëve të ngrohjes dhe impianteve të ftohjes dhe të përbërësve kryesorë të tij, krahasuar me kërkesat e ndërtesës dhe do të marrë në konsideratë aftësitë e sistemit për të optimizuar performancën e tij në kushte tipike ose mesatare të funksionimit, duke përdorur teknologjitë e disponueshme me eficiencë të lartë energjetike dhe

në kushtet e ndryshueshme për shkak të ndryshimeve të përdorimit.

Aty ku është e nevojshme, vlerësimi do të konsiderojë fizibilitetin e sistemit për të operuar në kushte të ndryshme dhe në temperatura eficiente, të tilla si në temperaturë të ulët për sistemet e ngrohjes me bazë uji, duke përfshirë projektimin e fuqisë termike në dalje dhe kërkesat e temperaturës dhe rrjedhës, duke siguruar funksionimin e sigurt të sistemit. Këqyrja, aty ku është e nevojshme, do të përfshijë një vlerësim bazë të fizibilitetit për të reduktuar përdorimin në vend të lëndëve djegëse fosile, për shembull duke integruar energjinë e rinovueshme, duke ndryshuar burimin e energjisë ose duke zëvendësuar ose rregulluar sistemet ekzistuese.

Kur është instaluar një sistem ventilimi, do të vlerësohen edhe përmasat e tij dhe aftësitë e tij për të optimizuar performancën e tij në kushte tipike ose mesatare të funksionimit, të rëndësishme për përdorimin specifik dhe aktual të ndërtesës.

6. Sistemet teknike të ndërtesave që mbulohen në mënyrë eksplicite nga një kriter i miratuar i performancës energjetike ose një marrëveshje kontraktuale që specifikon një nivel të dakordësuar të përmirësimit të eficiencës energjetike, siç është kontraktimi i performancës energjetike, ose që operohen nga një operator komunal ose rrjeti dhe për këtë arsye i nënshtrohen monitorimit të performancës, do të përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, me kusht që ndikimi i përgjithshëm i një qasjeje të tillë të jetë i barabartë me atë që rezulton nga pika 1 e këtij neni.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton aktin nënligjor, i cili përcakton përmbajtjen, metodat, kushtet dhe afatet për vlerësimin e sistemeve teknike në ndërtesa.

8. Vendimi i sipërpërmendur përcakton skema kontrolli ose masa alternative si mjetet digjitale dhe listat kontrolluese për të vërtetuar se punimet e dorëzuara të ndërtimit dhe rinovimit plotësojnë performancën e projektuar energjetike dhe janë në përputhje me kërkesat minimale të performancës energjetike të përcaktuara në kodet ose rregulloret ekuivalente.

9. Një analizë e përmbledhur e skemave të vlerësimit dhe rezultateve të tyre do të përfshihet si një aneks i Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.



Neni 23

Raporte për vlerësimin e sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar

1. Pas çdo vlerësimi të sistemit të ngrohjes, sistemit të ventilimit ose sistemit të ajrit të kondicionuar nga ekspertët e certifikuar sipas shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 24 të këtij ligji, do të lëshohet një raport. Raporti i vlerësimit duhet të përmbajë rezultatin e vlerësimit të kryer në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, dhe të përfshijë rekomandime për përmirësimin me kosto efektive të performancës energjetike të sistemit.

2. Këto rekomandime mund të bazohen në një krahasim të performancës energjetike të sistemit të vlerësuar me atë të sistemit më të mirë të mundshëm të disponueshëm, duke përdorur teknologji të kursimit të energjisë dhe një sistem të llojit të ngjashëm për të cilin të gjithë komponentët përkatës arrijnë nivelin e performancës energjetike, sipas kërkesave të ligjit në fuqi. Rekomandimet, sipas rastit, do të përfshijnë rezultatet nga vlerësimi bazë i zbatueshmërisë për të reduktuar përdorimin në vend të lëndëve djegëse fosile.

3. Raporti i vlerësimit duhet të tregojë çdo çështje sigurie që është zbuluar gjatë inspektimit. Megjithatë, autori i raportit nuk do të konsiderohet si përgjegjës në lidhje me zbulimin ose treguesin e ndonjë çështjeje të tillë sigurie.

4. Raporti i vlerësimit i dorëzohet pronarit ose qiramarrësit të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës.

5. Raporti i vlerësimit do të ngarkohet në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave sipas nenit 29 të këtij ligji.

KREU VI

EKSPERTËT E PAVARUR DHE SISTEMI I MBIKËQYRJES

Neni 24

Ekspertët e pavarur

1. Certifikimi i performancës energjetike të ndërtesave, hartimi dhe plotësimi i librezave të rinovimit dhe vlerësimi i sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar kryhen në mënyrë të pavarur nga ekspertë të pavarur e të certifikuar, që operojnë në

cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit nga subjektet private ose ndërmarrjet private.

2. Ekspertët e pavarur certifikohen nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

3. Për qëllim të këtij neni, ekspertët e pavarur certifikohen, si:

a) auditues energjetik për ndërtesa;

b) vlerësues për sistemet teknike në ndërtesa.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave, sipas përmbajtjes së pikës 4 të këtij neni, përcakton:

a) kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të ekspertëve të pavarur së bashku me autorizimin e tyre për të kryer shërbimet energjetike në objekte të ndryshme;

b) kriteret për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë;

c) një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjislacionin përkatës kombëtar, standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjetik dhe menaxhimit energjetik, trajnime teknike për teknikat e auditimit energjetik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raporti auditimi;

ç) parashikimin e kryerjes së testeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe certifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;

d) rregullat dhe kriteret për ngritjen e komisioneve të testimit;

dh) rregulla procedurale për njësimin e certifikatave të ekspertëve të pavarur, të lëshuara nga institucione të huaja;

e) kodin e sjelljes së ekspertëve të pavarur;

ë) raportimet e detyrueshme;

f) metodat e procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve dhe vlerësimeve energjetike, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje të konsiderueshme statistikore të raporteve të auditimit



energjetik dhe raporteve të vlerësimit të sistemeve teknike që ata realizojnë;

g) vendosjen e kritereve minimale transparente dhe jodiskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të shërbimeve energjetike të ofruara nga ekspertët e pavarur;

gj) arsyet dhe procedurat për vendosjen e masave administrative, për shkak të performancës së dobët ose shkeljes së kodit të sjelljes;

h) kredite mbi trajnimet e zhvillimit profesional.

6. Agjencia përgjegjëse për eficiencën dhe ministria përgjegjëse për energjinë publikojnë listën e ekspertëve të certifikuar në faqen e tyre të internetit.

7. Ekspertët e certifikuar regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e shërbimit sipas certifikatës që zotërojnë.

8. Ekspertët e pavarur nuk kryejnë shërbime energjetike sipas certifikimit të tyre:

a) në shoqëri në të cilat zotërojnë aksione ose kuota;

b) në shoqëri në të cilën janë anëtarë të një organi drejtues ose janë të punësuar nga personi të cilit i kërkohet të realizojë secilin nga shërbimet energjetike për të cilin ato janë certifikuar;

c) kur rezultojnë të afërm të shkallës së dytë me personat që u ofrojnë secilin nga shërbimet energjetike për të cilin ato janë certifikuar;

ç) në objekte të cilat kanë gjeneruar certifikatat paraprake të performancës energjetike;

d) në çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

9. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë vendos në dispozicion të palëve të interesuara informacionin mbi trajnimet dhe certifikimet e disponueshme.

Neni 25

Mbikëqyrja e ekspertëve të performancës energjetike të ndërtesave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën, kriteret, kushtet, kërkesat dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve të kryera nga ekspertët e pavarur.

2. Vendimi sipas pikës 1 të këtij neni përcakton bazat për krijimin e sistemeve të pavarura të kontrollit për certifikatat e performancës energjetike,

sistemet e pavarura të kontrollit për librezat e rinovimit dhe raportet e vlerësimit të sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar.

3. Procesi i mbikëqyrjes realizohet nga ekspertët e certifikuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, sipas procedurës së parashikuar në pikën 4 të nenit 24 të këtij ligji, të cilët janë punonjës prej më shumë se tre vjetësh në institucionet publike që ngarkohen me përgjegjësinë e realizimit të procesit të mbikëqyrjes.

4. Vendimi sipas pikës 1 përcakton në mënyrë të detajuar kriteret dhe kushtet për klasifikimin e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në:

a) shkelje, e cila shoqërohet me masë administrative;

b) shkelje e rëndë për të cilën ekspertit të pavarur, përveç masës administrative sipas shkronjës “a”, i revokohet certifikata për një periudhë 1-vjeçare.

5. Ekspertët e pavarur, të cilëve iu është revokuar certifikata sipas shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të sipërpërmendur. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.

6. Ekspertët e pavarur janë të detyruar të vendosin në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës të gjithë materialin dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së:

a) certifikatës së performancës energjetike të ndërtesës;

b) librezës së rinovimit të ndërtesës;

c) raportit të vlerësimit të sistemit teknik të ndërtesës.

7. Për ekspertët e pavarur, që nuk vendosin në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës materialin sipas pikës 6 të këtij neni, zbatohen masat e parashikuara sipas shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni.

KREU VII

MODELI SHEMBULLOR I NDËRTESAVE PUBLIKE

Neni 26

Rinovimi i ndërtesave publike

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, sektori publik ngarkohet me zbatimin e objektivit të rinovimit të



ndërtesave publike për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin që përcakton sasinë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t'u rinovuar çdo vit kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike. Ky vendim i Këshillit të Ministrave përfshin:

a) një metodologji të veçantë që përdoret për përcaktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e përqindjes përkatëse të ndërtesave publike;

b) përcaktimin e sipërfaqes totale të ndërtesave publike;

c) tipologjinë e ndërtesave që kërkohet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, dhe të atyre të përjashtuara nga ky detyrim;

ç) zbatueshmërinë mbi ndërtesat e shfrytëzuara nga organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe ato të vartësisë;

d) masa të tjera, të cilat zbatohen për të mundësuar rinovimin tërësor të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i parashikuar në pikën 2 të këtij neni:

a) përcakton si objektiv ndërtesat e organeve të qeverisjes qendrore me performancën më të ulët të energjisë, të cilat kanë përparësi lidhur me masat për eficiencën e energjisë, kur kjo është e mundur si nga pikëpamja e koston efektive, ashtu edhe teknikisht e realizueshme;

b) hartohet në përputhje me përmbajtjen e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.

4. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë mbledh, administron, përpunon dhe publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m². Inventari përfshin:

a) sipërfaqen totale të kateve në metra katrorë;

b) performancën aktuale të energjisë së secilës ndërtesë ose të dhënat përkatëse që lidhen me energjinë, duke përcaktuar objektivin e performancës.

5. Me qëllim përgatitjen e inventarit, ministria kryesisht dhe përmes agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë realizon procesin e mbledhjes së informacionit të nevojshëm sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Subjektet përkatëse të sektorit publik janë të detyruara të japin informacionin e kërkuar për stokun brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.

7. Objektivat e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni përfshihen në Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

Neni 27

Administratorët e energjisë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në çdo ndërtesë publike nominohet një administrator energjie nga trupa e punonjësve të brendshëm, i cili, ndër të tjera, do të jetë përgjegjës për të zbatuar masat e ruajtjes së energjisë, me qëllim reduktimin e konsumit energjetik për ndërtesën në të cilën është përgjegjës.

2. Administratorët e energjisë janë përgjegjës për:

a) raportimin mujor të faturave të energjisë elektrike dhe burimeve të tjera energjetike që përdoren në ndërtesë;

b) raportimin e orëve gjatë të cilave funksionon sistemi i ngrohjes/ftohjes së ndërtesës;

c) zbatimin e masave që lidhen me ruajtjen e energjisë në ndërtesa;

ç) detyra të tjera të caktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 4 të këtij neni.

3. Administratorët e energjisë caktohen nga titullari i institucionit dhe qëndrojnë në komunikim të vazhdueshëm me nëpunësit e agjencisë dhe ministrinë përgjegjëse për energjinë.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, harton vendimin që përcakton përgjegjësitë, kushtet, kriteret dhe skemat e përcaktimit të bonuseve apo të shpërblimit për administratorët e energjisë, bazuar mbi performancën.

5. Në përputhje me pikën 4 të këtij neni, administratorët e energjisë raportojnë në mënyrë periodike sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.



KREU VIII

BAZA E TË DHËNAVE, INFORMACIONI
DHE MASAT MBËSHTETËSE

Neni 28

**Disponueshmëria e të dhënave dhe
informacionit**

1. Ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kadastrën, agjencinë përgjegjëse për eficiencën, si dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal hartojnë vendimin për krijimin e bazës kombëtare të të dhënave energjetike të ndërtesave, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Çdo ndërtesë e re që aplikon për leje ndërtimi (në fazë projekti), shfrytëzimi (në fazë projekti), si dhe çdo ndërtesë ekzistuese pajiset me një ndërfaqe ku pasqyrohet i gjithë informacioni i disponueshëm për performancën energjetike.

3. Vendimi sipas pikës 1 të këtij neni përmban të paktën të dhënat e mëposhtme për:

- a) performancën energjetike të ndërtesës, të elementeve të ndërtesës, si dhe të sistemeve teknike;
- b) sistemet e automatizimit e të kontrollit;
- c) matësit e energjisë dhe të dhënat e konsumit energjetik;
- ç) pajisje të tjera për matjen dhe kontrollin;
- d) stacionet e karikimit të ndodhura në brendësi ose pranë ndërtesës;
- dh) ndërlidhjet inteligjente përmes IoT-së dhe raportim në kohë reale;
- e) të dhëna të tjera.

4. Informacioni i mbledhur në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave është pa pagesë për pronarët ose qiramarrësit e ndërtesave, ndërsa për palë të tjera të interesuara, si institucionet financiare, agregatorët, furnizuesit e energjisë do të mund të aksesojnë të dhënat përmes pagesës së miratuar në vendimin sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Aksesimi i të dhënave do të mundësohet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e konfidencialitetit.

Neni 29

**Baza e të dhënave për performancën e
energjisë në ndërtesa**

1. Këshilli i Ministrave krijon dhe miraton një bazë të dhënash kombëtare për performancën energjetike të ndërtesave, e cila lejon mbledhjen e të dhënave mbi performancën energjetike të ndërtesave individuale dhe mbi performancën e përgjithshme energjetike të stokut kombëtar të ndërtesave.

Baza e të dhënave lejon mbledhjen e të dhënave nga të gjitha burimet përkatëse në lidhje me certifikatat e performancës energjetike, vlerësimet, inspektimet, librezën e rinovimit, treguesin digjital të ndërtesës dhe konsumin e llogaritur ose të matur të energjisë së ndërtesave.

2. Të dhënat e grumbulluara të stokut të ndërtesave do të vihen në dispozicion të publikut, në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave. Të dhënat e ruajtura duhet të jenë të lexueshme nga makineritë dhe të aksesueshme nëpërmjet një ndërfaqeje të përshtatshme digjitale.

3. Certifikata e performancës energjetike, e ngarkuar në bazën e të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave, aksesohet lehtësisht dhe pa pagesë nga pronarët, qiramarrësit dhe menaxherët e ndërtesave dhe për institucionet financiare në lidhje me ndërtesat në portofolat e tyre të investimeve dhe huadhënies edhe nga ekspertë të pavarur me autorizim nga pronari. Për ndërtesat e ofruara me qira ose shitje, pronarët e ndërtesave janë të detyruar të lejojnë aksesimin e certifikatës së plotë të performancës energjetike në bazën e të dhënave për qiramarrësit ose blerësit e mundshëm.

4. Informacioni i mbledhur në bazën e të dhënave kombëtare vendoset në dispozicion të publikut për sa i përket stokut kombëtar të pajisur me certifikatën e performancës energjetike dhe të dhëna të tjera mbi performancën energjetike, duke përfshirë konsumin energjetik dhe, kur është e mundur, PNG-në gjatë ciklit jetësor për ndërtesat e vlerësuara. Informacioni publik përditësohet të paktën dy herë në vit.

5. Informacioni sipas këtij neni përcillet të paktën 1 (një) herë në vit te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë sipas formatit të miratuar me urdhrë të ministrit përgjegjës për energjinë.



6. Në vendimin për krijimin e bazës së të dhënave përcaktohet në mënyrë të detajuar:

- a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;
- b) të dhënat parësore dhe dytësore;
- c) dhënësi/dhënësit e informacionit;
- ç) ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave;
- d) niveli i aksesimit për subjektet e interesuara.

7. Sipas kërkesës, institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore vendos në dispozicion informacionin anonim ose të përmbledhur për të gjitha institucionet publike kërkimore/shkencore, si dhe për institutin përgjegjës për statistikat kombëtare.

Neni 30

Skema mbështetëse për rritjen e performancës energjetike

1. Këshilli i Ministrave miraton skema mbështetëse për të bashkëfinancuar dhe adresuar barrierat e tregut për:

- a) Planin Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave sipas nenit 5 të këtij ligji;
- b) rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave publike sipas nenit 26 të këtij ligji;
- c) auditimin dhe certifikimin e ndërtesave sipas nenit 16 të këtij ligji;
- ç) zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë lëndë djegëse fosile me sisteme alternative me eficiencë të lartë energjetike që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie në përputhje me raportet e vlerësimit të sistemeve teknike në ndërtesa, sipas pikës 7 të nenit 19 të këtij ligji;
- d) zhvillimin e infrastrukturës për lëvizshmëri të qëndrueshme, sipas nenit 14 të këtij ligji.

2. Vendimi sipas pikës 1 përcakton në mënyrë të detajuar mënyrën e funksionimit të skemës, burimin e financimit, institucionin përgjegjës për administrimin e skemës, si dhe kushtet, kategoritë dhe kërkesat për përfituesit, të drejtat dhe detyrimet, si dhe elemente të tjera të nevojshme për aplikimin e masave mbështetëse.

3. Udhëzimet, formularët e aplikimit, rregullorja, si dhe organizimi i fushatës informuese për të gjitha palët e interesuara do të miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë, me propozimin e institucionit përgjegjës për administrimin e skemës.

4. Për ndërtesat me shumë njësi banimi (si ndërtesat me shumë apartamente) kuorumi i nevojshëm për të aplikuar dhe proceduar me realizimin e skemës së mbështetjes është 60% e pronarëve të njërive të banimit.

5. Gjatë rinovimit të ndërtesave do të merren parasysh në çdo rast qëndrueshmëria sizmike, mbrojtja nga zjarri dhe aksesit në ndërtesë i personave me aftësi të kufizuara.

6. Çdo institucion publik dhe ndërmarrje shtetërore, duke përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, operatorët e sistemit të shpërndarjes etj., mundësojnë dhënien e lejeve sipas fushës së përgjegjësisë me procedurë të përsheptuar për çdo përfitues të skemave mbështetëse.

Neni 31

Këshillim dhe asistencë për performancën energjetike të ndërtesave

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, agjencia dhe ministria përgjegjëse për energjinë nëpërmjet strukturave të tyre ofrojnë asistencë administrative, teknike dhe çdo informacion mbi skemat e financimit për performancën energjetike të ndërtesave për të gjithë aktorët e përfshirë në rinovimin e ndërtesave.

2. Ministri përgjegjës për energjinë miraton udhëzimin për mënyrën e ofrimit të këshillimit dhe asistencës për performancën energjetike të ndërtesave ku, ndër të tjera, duhet:

- a) të sigurojë informacione të thjeshta për mundësitë dhe zgjidhjet teknike e financiare për familjet, NVM-të dhe organet publike;
- b) të japë këshilla të pavarura për performancën energjetike të ndërtesave dhe mund të shoqërojë programet e integruara të rinovimit të rretheve;
- c) të ofrojë shërbime të dedikuara për familjet në nevojë, njerëzit e prekur nga varfëria energjetike dhe njerëzit në familje me të ardhura të ulëta;
- ç) të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për të gjitha familjet, me fokus të veçantë në familjet e prekura nga varfëria energjetike dhe në ndërtesat me performancën shumë të ulët, si dhe për kompanitë dhe instaluesit e akredituar që ofrojnë shërbime të rinovimit, të përshtatura me tipologjitë e ndryshme të banesave dhe shtrirjen gjeografike, dhe ofron mbështetje që mbulon faza të ndryshme të projektit të rinovimit.

Neni 32
Informacion

1. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë harton strategjinë për fushatën e informimit dhe trajnimit të palëve të interesuara mbi masat, alternativat, mekanizmat e financimit, përfitimet dhe ndërgjegjësimin lidhur me eficiencën energjetike.

2. Fushatat e informimit dhe trajnimit për përmirësimin e eficiencës energjetike përfshijnë të paktën:

a) pronarët dhe qiramarrësit e ndërtesave ose njësisë të ndërtesave;

b) aktorët e tjerë të tregut të ndërtesave, si kompanitë e ndërtimit ose shitjes së ndërtesave;

c) njësitë e qeverisjes vendore e rajonale, komunitetet e energjisë, si dhe familjet e cenueshme dhe familjet që jetojnë në varfëri energjetike;

ç) organizatat e shoqërisë civile dhe administratorët e ndërtesave;

d) administratorët e energjisë dhe ekspertët e pavarur të energjisë etj.

3. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë përgatit udhëzimet dhe trajnimet e nevojshme për palët e detyruara dhe palët e interesuara nga ky ligj, të cilat theksojnë rëndësinë e përmirësimit të performancës energjetike dhe që lehtësojnë marrjen në konsideratë të përmirësimeve optimale në eficiencën energjetike, reduktimin e gazeve me efekt serrë, përdorimin e burimeve të rinovueshme energjetike, si dhe përdorimin e ngrohjes dhe ftohjes qendrore gjatë planifikimit, projektimit, ndërtimit dhe rinovimit të zonave industriale dhe rezidenciale.

4. Udhëzime dhe trajnime të tilla mund të adresojnë gjithashtu përmirësimet strukturore, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sigurinë nga zjarri, rreziqet që lidhen me aktivitetin intensiv sizmik, heqjen e substancave të rrezikshme, duke përfshirë asbestin, emetimet e ndotësve të ajrit (përfshirë grimcat e imëta), cilësinë e ambientit të brendshëm dhe aksesin në ndërtesa për personat me aftësi të kufizuara.

5. Agjencia për eficiencën e energjisë raporton mbi progresin e strategjisë para datës 31 mars të çdo viti pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDITNeni 33
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 1 dhe pikën 6 të nenit 16 të këtij ligji, subjekti, që ka në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesën, dënohet me gjobë në masën 250 lekë/m² (sipërfaqe bruto), ndërsa subjektet që janë të përfshira në reklamimin e pronave *on-line* ose jo, dënohen me gjobë në masën 200 000.00 lekë.

b) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikat 8 dhe 9 të nenit 16 dhe në pikën 5 të nenit 21 të këtij ligji, subjektet dënohen me gjobë në masën 500 000.00 lekë;

c) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 17 të këtij ligji, subjekti, që ka në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesën, dënohet me gjobë në masën 30 000.00 lekë;

ç) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 5 të nenit 18 të këtij ligji, subjekti projektues dënohet me gjobë në masën 300 000.00 lekë;

d) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 22 të këtij ligji, subjekti pronar ose administrues i pronës dënohet me gjobë në masën 100 000.00 lekë dhe 200 000.00 lekë;

dh) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 1 000 000.00 lekë;

e) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikat 7 dhe 8 të nenit 24 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 1 000 000.00 lekë dhe ekspertiza do të vlerësohet e pavlefshme;

ë) për shkeljet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, miratuar sipas shkronjës “a” të pikës 4 të nenit 25, ekspertët dënohen me gjobë në masën 1 000 000.00 lekë;

f) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, subjekti pronar ose administrues i pronës dënohet me gjobë në masën 300 000.00 lekë;



g) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikat 9 dhe 5 të nenit 27 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 5 000.00 lekë;

gj) për moszbatim të detyrimeve, të cilat do të përcaktohen në aktin përkatës nënligjor, sipas pikës 7 të nenit 12, personi përgjegjës për zbatimin e punimeve dënohet me gjobë në masën 1 000 lekë/m² (sipërfaqe bruto);

h) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 13 të këtij ligji, subjekti dhe personi përgjegjës për zbatimin e punimeve dënohen me gjobë në masën 1 000 lekë/m² (sipërfaqe bruto);

i) për moszbatim të detyrimeve, të cilat do të përcaktohen në aktin përkatës nënligjor, sipas pikës 7 të nenit 14 të këtij ligji, subjektet dënohen me gjobë në masën 300 000.00 lekë.

2. Kundërvajtjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni konstatohen nga ekspertët e pavarur, Agjencia e Eficiencës së Energjisë ose menaxherët e energjisë nëpërmjet aktkonstatimeve, të cilat i përcillen Agjencisë së Eficiencës së energjisë ose autoriteteve përgjegjëse sipas pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji, për marrjen e masës administrative përkatëse.

3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të komisioneve të mbikëqyrjes bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

4. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i masave administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 34

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 6; 8, pika 16; 9, pika 1; 10, pika 6; 12, pikat 3 dhe 7; 14, pika 7; 15, pika 18; 18, pika 3; 19, pika 5; 21, pika 5; 22, pika 7; 24, pika 4; 25, pika 1; 26, pika 2; 27, pika 4; 28, pika 1; 29, pika 1; dhe 30, pika 1, të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që brenda 20 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 4; 20, pika 4; 27, pika 5; 29, pika 5; 30, pika 3, dhe 31, pika 2, të tij.

Neni 35

Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore, që janë miratuar në përputhje me ligjin nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave” qëndrojnë në fuqi nëse nuk bien ndesh me këtë ligj ose deri kur të zëvendësohen nga akte të tjera nënligjore të këtij ligji.

Neni 36

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave” dhe shkronja “a” e pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 213, datë 3.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 213, datë 3.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 37/2025, “Për performancën energjetike të ndërtesave”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 46/2025

**PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN,
TREGTIMIN DHE PËRDORIMIN
E BIOKARBURANTEVE DHE TË
LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE,
TË RINOVUESHME PËR TRANSPORT²**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij ligji është promovimi i prodhimit dhe i përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme në sektorin e transportit në Republikën e Shqipërisë.

2. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për:

- përmbushjen e objektivave lidhur me përdorimin e burimeve të rinovueshme, të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë;
- nxitjen e kultivimit të bimëve energjetike për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa;
- plotësimin e kërkesave për cilësinë e karburanteve në sektorin e transportit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të cilat në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto,

² Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 11 dhjetor 2018, “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar me direktivën

përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.

2. Ky ligj zbatohet në veprimtarinë e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit kombëtar, kur nivelet e biodiezelit dhe bioetanolit janë në përputhje me specifikimet e dhëna në standardet shqiptare, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Biogaz” është lëndë djegëse, e gaztë, e prodhuar nga biomasa.

2. “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga bujqësia, duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore nga pylltaria dhe industritë e ndërlidhura, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe pjesët e biodegradueshme të mbeturinave, përfshirë mbeturinat industriale dhe urbane me origjinë biologjike.

3. “Biokarburante” është lëndë djegëse, e lëngshme, për transportin e prodhuar nga biomasa.

4. “Biokarburantet e avancuara” janë biokarburantet që prodhohen nga lëndët e para, si më poshtë:

a) algat, nëse kultivohen në tokë në pellgje ose fotobioreaktorë;

b) pjesa e biomasës e mbetjeve të përziera bashkiake, por jo mbetje shtëpiake të ndara;

c) mbetjet biologjike, që vijnë nga mbetje të materialeve të biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, ushqimet dhe mbetjet ushqimore nga amvisat, zyrat, restorantet, *catering*-ët dhe ambientet e shitjes me pakicë e shumicë dhe mbetje nga stabilimentet e përpunimit të ushqimit;

ç) pjesa e biomasës e mbetjeve industriale, të papërshtatshme për t’u përdorur në zinxhirin ushqimor, duke përfshirë materialet nga shitja me pakicë e shumicë dhe industria agroushqimore, peshku dhe akuakultura e duke përjashtuar vajin e përdorur të gatimit dhe yndyrat shtazore;

d) kashta;

(BE) 2023/2413 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 18 tetor 2023. Numri CELEX: 32018L2001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 328, datë 21.12.2018, f. 82–209.



dh) plehu i kafshëve dhe llumrat e ujërave të zeza;
e) efluenti i mullirit të vajit të palmës dhe tufat bosh të frutave të palmës;

ë) vaji me përmbajtje të lartë katrani;

f) glicerina e papërpunuar;

g) bagas;

gj) mbetjet e rrushit dhe llumi i verës;

h) lëvozhgat e arrave;

i) lëvozhgat;

j) koçani i pastruar nga kokrrat e misrit;

k) pjesa e biomasës e mbetjeve dhe mbetjeve nga pylltaria, industritë e bazuara në pyje, konkretisht, lëvorja, degët, rrallimet paratregtare, gjetet, gjilpërat, majat e pemëve, pluhuri i sharrës, ashkla prerëse, lëngjet e zeza, lëngjet kafe, llumi me fibra, linjina dhe vaj i gjatë;

l) materiale të tjera celulozike joushqimore;

ll) materiale të tjera ligno-celulozike, përveç trungjeve të sharrës dhe trungjeve të rimesove.

5. “Biolëngjet” janë lëndë djegëse, të lëngshme, për qëllime energjetike, të ndryshme nga ato për transport, duke përfshirë energjinë elektrike, si ngrohjen dhe ftohjen, e prodhuar nga biomasa.

6. “Biokarburantet me rrezik të ulët indirekt në ndryshimin e përdorimit të tokës, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës” janë biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës, lënda e parë e të cilave prodhohet nëpërmjet skemave që shmangin efektet e zhvendosjes së biokarburanteve me bazë nga ushqimet dhe kulturat bujqësore, biolëngjeve dhe lëndëve djegëse të biomasës përmes praktikave të përmirësuara bujqësore, si dhe përmes kultivimit të kulturave në zona, të cilat më parë nuk janë përdorur për kultivimin e kulturave bujqësore dhe që janë prodhuar në përputhje me kriterin e qëndrueshmërisë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës, si dhe përmes kultivimit të kulturave jo në zonat ku kultivohen kulturat bujqësore dhe jo në tokat bujqësore.

7. “Impiantet për përzierjen e biokarburanteve” janë instalime teknologjike të posaçme, me mjedise të nevojshme magazinimi, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me nënproduktet përkatëse, të prodhuara nga përpunimi i naftës bruto.

8. “Impiante për prodhimin e biokarburanteve” janë instalime teknologjike të posaçme, të zotëruara nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve, në të cilat realizohet prodhimi i biokarburanteve ose i

lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit.

9. “Kodi VIII.1.A” është kodi “Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse” për të cilin personat juridikë aplikojnë për licencë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në zbatim të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. “Konsumatorë të mëdhenj” kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

11. “Kulturat bujqësore që përdoren për ushqim dhe ushqim për kafshët” janë kulturat bujqësore, të pasura me niseshte, me përmbajtje sheqerna ose vajore, të prodhuara në tokë bujqësore, si kulturë kryesore, duke përjashtuar mbetjet, mbeturinat ose materialet ligno-celulozike dhe kulturat e ndërmjetme, të tilla si kulturat kapëse dhe mbuluese, me kusht që përdorimi i këtyre kulturave të ndërmjetme nuk kërkon tokë shtesë.

12. “Lëndë djegëse nga biomasa” janë karburantet e gazta, të lëngëta dhe të ngurta, të prodhuara nga biomasa.

13. “Lëndë djegëse të rinovueshme” janë biokarburantet, biolëngjet, lëndët djegëse të biomasës dhe lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike.

14. “Lëndë djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike” janë lëndët djegëse të lëngëta dhe të gazta, përmbajtja energjetike e të cilave rrjedh nga burime të rinovueshme, të ndryshme nga biomasa.

15. “Materiali celuloz joushqimor” është lëndë e parë, e përbërë kryesisht nga celulozë dhe hemicelulozë dhe që ka një përmbajtje më të ulët të linjinës së materialit ligno-celuloz, duke përfshirë mbetjet nga kulturat bujqësore dhe kulturat bimore për ushqim për kafshë, si: kashta, kalli misri, lëvozhgat dhe guaskat, kultura energjetike bimore/barishtore, me përmbajtje të ulët niseshteje, të tilla, si: thekër, gërshetues, miskanthus, kallam gjigant, kulturat mbuluese para dhe pas kulturave kryesore, kultura që përdoren në qarkullimin bujqësor, mbetjet industriale, duke përfshirë nga kulturat bujqësore, që përdoren si ushqim dhe ushqim për kafshët, pas nxjerrjes së vajrave vegjetale, sheqernave, niseshtesë e proteinave dhe materiali nga mbetjet biologjike, ku kulturat që



përdoren në qarkullimin bimor dhe ato në mbulesë kuptohen se janë kullota të përkohshme, të mbjella afatshkurtra, që përmbajnë përzierje barrera-bishtajor, me një përmbajtje të ulët niseshteje, për të marrë foragjerë për kafshët dhe për të përmirësuar pjellorinë e tokës për marrjen e rendimenteve më të larta të kulturave kryesore bujqësore.

16. “Materiali ligno-celuloz” është materiali i përbërë nga linjina, celuloza dhe hemiceluloza, si biomasa me burim nga pyjet, kulturat energjetike drusore, mbetjet industriale me prejardhje pyjore dhe mbetjet.

17. “Mbeturina” janë substanca që nuk janë produkti përfundimtar, që një proces prodhimi kërkon të prodhojë drejtpërdrejt, nuk është qëllimi kryesor i procesit të prodhimit dhe procesi nuk është modifikuar qëllimisht për ta prodhuar atë.

18. “Mbetje” është çdo substancë ose objekt, që zotëruesi e hedh ose synon ose i kërkohet ta hedhë, duke përjashtuar substancat që janë modifikuar ose janë kontaminuar qëllimisht për të përmbushur këtë përkufizim.

19. “Njësi të përzierjes së biokarburanteve” janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme me nënproduktet përkatëse, të prodhuara nga përpunimi i naftës bruto.

20. “Njësi të prodhimit të biokarburanteve” janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

21. “Përzierja e biokarburanteve” është procesi i përzierjes së biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet përkatëse konvencionale, të përfutuara nga distilimi i naftës bruto.

22. “Prodhimi i biokarburanteve” është përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme të prodhimit të biokarburanteve, sipas përcaktimeve të mësipërme ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

23. “Rafineri” është instalim kompleks teknologjik, përfshirë edhe kapacitetet depozituese të lëndës së parë, të gjysmëprodukteve dhe produkteve të gatshme, ku kryhet përpunimi i naftës bruto apo i nënprodukteve të saj për përfutimin e nënprodukteve apo produkteve të gatshme.

24. “Shoqëri tregtimi me shumicë” është personi juridik që blen naftë bruto dhe nënproduktet e saj,

përfshirë biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, me qëllim shitjeje te konsumatorët e mëdhenj ose te të tretët për rishitje.

25. “Shoqëri tregtimi me pakicë” është personi juridik që blen nënprodukte të naftës bruto, përfshirë biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, me qëllim shitjeje te personat që janë konsumatorë fundorë.

26. Termat “Standard”, “Standard shqiptar” dhe “Rregulla teknike” në këtë ligj kanë të njëjtin kuptim me kuptimin e dhënë në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, i ndryshuar.

Neni 4

Objektivat kombëtarë

1. Përcaktimet e këtij ligji lidhen me ushtrimin e veprimtarive të prodhimit, tregtimit, transportimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport dhe synohet të arrihen këta objektiva:

a) sasia minimale vjetore në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport, të cilat plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet duhet të jetë jo më pak se 1 për qind e sasisë së konsumit përfundimtar të lëndëve djegëse në sektorin e transportit duke filluar nga viti 2026 deri në vitin 2030. Kjo sasi do të rritet gradualisht me të paktën 1% në vit, me synimin që në vitin 2030 të jetë jo më pak se 7%;

b) nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, në sektorin e transportit kombëtar, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të shprehur në përqindje, për praninë në treg të këtyre produkteve;

c) garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin e përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme;

ç) dhënia e kontributit në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit;

d) zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe pyjeve, si stimul për zhvillimin rural



dhe nxitjen e punësimit, duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë e të reduktimit të emetimeve të gazeve serrë. Në realizimin e këtij objekti do të mbahet parasysh dhe do të stimulohen skemat mbështetëse për energjinë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës, në mënyrë të tillë që të shmanget moszbatimi i kriterëve të qëndrueshmërisë dhe konkurrenca deformuese në këtë fushë, me qëllim që të sigurohet se përdoret biomasa drusore sipas vlerës më të lartë të shtuar ekonomike dhe mjedisore, sipas prioriteteve të mëposhtme:

- i. produkte me bazë druri;
- ii. zgjatja e jetëgjatësisë së produkteve me bazë druri;
- iii. ripërdorimi;
- iv. riciklimi;
- v. bioenergji;
- vi. asgjësimi.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë i raporton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përmbushjen e objektivave kombëtarë për përdorimin e biokarburanteve dhe lëndëve djegëse të tjera, të rinovueshme në sektorin e transportit.

Neni 5

Përlllogaritja e sasisë vjetore minimale të konsumit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme

1. Sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, që do të përdoret gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, përcaktohet në raport me sasinë vjetore të lëndëve djegëse të vendosura në treg për transport nga shoqëritë e tregtimit me shumicë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton udhëzimin për mënyrën e përcaktimit të sasisë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të vendosura në treg në sektorin e transportit.

3. Mbi bazën e objektivave kombëtarë vjetorë, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, ministri përgjegjës për energjinë përcakton me urdhër sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, si dhe sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera

djegëse, të rinovueshme, që do të hidhen në treg gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit nga personat juridikë, të pajisur me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”.

4. Të dhënat për sasinë minimale të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit gjatë vitit pasardhës, publikohen në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për energjinë.

5. Personi juridik, i pajisur me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”, realizon hedhjen në treg të sasisë minimale të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme vjetore, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Këto sasi duhet të certifikohen për plotësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, në përputhje me parashikimet e përcaktuara në nenet 6 e 7 të këtij ligji, dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë.

6. Nëse në treg ka persona juridikë, të cilët kanë sasi më tepër nga sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, që përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, këto sasi mund t’iu shiten subjekteve juridike, të cilat, për arsye të ndryshme, nuk plotësojnë kërkesën për sasinë minimale vjetore të biokarburanteve.

7. Personat juridikë, të pajisur me licencë të tregtimit me shumicë, janë të detyruar të raportojnë në ministri për përmbushjen e detyrimit, të përcaktuar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, në përputhje me udhëzimin e Këshillit të Ministrave.

8. Konsumi përfundimtar i energjisë nga burimet e rinovueshme në sektorin e transportit do të llogaritet si shuma e të gjitha biokarburanteve, biogazi dhe lëndët djegëse të rinovueshme, me origjinë jobiologjike, të konsumuara në sektorin e transportit. Kjo do të përfshijë edhe lëndët djegëse të rinovueshme për konsum vetjak të mjeteve detare ndërkombëtare. Në këtë llogaritje duhet të merret në konsideratë përmbajtja energjetike e lëndëve djegëse, duke zbatuar standardet në fuqi në Shqipëri. Në ato raste kur standardet shqiptare mungojnë, përdoren ato të Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO).



Neni 6

Qëndrueshmëria dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet

1. Energjia e prodhuar nga biokarburantet apo biolëngjet, pavarësisht nëse lëndët e para që kanë shërbyer për prodhimin e biokarburanteve janë kultivuar brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, merret në konsideratë sipas qëllimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, vetëm nëse përmbushen kriteret e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet.

2. Energjia e prodhuar nga biokarburantet dhe lëndët djegëse të rinovueshme për transport merret në konsideratë pasi përmbushen kriteret e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për qëllimet si më poshtë:

a) për përmbushjen e objektivave kombëtarë në konsumin final të energjisë për pjesën që lidhet me konsumin e energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë në sektorin e transportit;

b) për pajtueshmërinë me detyrimet e vendosura nga legjislacioni dhe Plani Kombëtar për Burimet e Rinovueshme të Energjisë;

c) pranueshmërinë për mbështetje financiare për konsumin e biokarburanteve dhe lëndëve të djegëse të rinovueshme për transport.

3. Biokarburantet dhe lëndët djegëse të rinovueshme për transport duhet të jenë të prodhuara nga lëndë të para, të cilat përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Biokarburantet dhe lëndët djegëse, të rinovueshme për transport, të prodhuara nga mbetje të tjera nga mbetjet bujqësore, akuakulturore, nga peshkimi dhe nga mbetjet e pyjeve, duhet të përmbushin vetëm kriteret e reduktimit të emetimeve të gazeve serrë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin, për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Rregullat për llogaritjen e ndikimit në uljen e sasisë së gazeve me efekt serrë nga prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe i lëndëve djegëse të rinovueshme për transport përcaktohen me urdhër

të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për energjinë.

Neni 7

Verifikimi i plotësimit të kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet

1. Në rastin kur biokarburantet dhe lëndët djegëse, të rinovueshme për transport, merren në konsideratë për qëllimet e parashikuara në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, struktura përgjegjëse për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet verifikon nëse operatorët ekonomikë kanë respektuar kriteret e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas pikave 4 dhe 5 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Për qëllim të llogaritjes së lëndëve djegëse të rinovueshme dhe lëndëve djegëse të karbonit të ricikluar për përmbushjen e objektivave dhe përcaktimeve në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, operatorët ekonomikë tregojnë gjatë auditimeve të detyrueshme të pavarura dhe transparente se përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë dhe të kursimit të emetimeve të gazeve serrë për karburantet e rinovueshme dhe karburantet me karbon të ricikluar.

3. Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, personat juridikë, të pajisur me licencë "Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A", sipas përcaktimeve në pikën 3 të nenit 5 të këtij ligji, janë të detyruar të informojnë për karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, si dhe mbi volumet e përzierjeve, të cilat duhet të mbahen të pandryshuara.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin për metodologjinë e llogaritjes së detyrimit kombëtar vjetor të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit, standardet e auditimit, strukturat përgjegjëse që do të bëjnë verifikimin e plotësimit të kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

5. Ministria përgjegjëse për energjinë raporton në mënyrë periodike te Sekretariati i Komunitetit të



Energjisë për masat kombëtare të marra për respektimin e kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.

6. Ministria përgjegjëse për transportin rrugor, nëpërmjet distributorëve ligjorë të mjeteve dhe klubit të automobilizmit në Republikën e Shqipërisë, publikon të dhëna për efektshmërinë e motorëve ekzistues, në përputhje me cilësinë e karburanteve të përdorura. Këto të dhëna duhet t'u vihen në dispozicion subjekteve juridike, të ngarkuara nga ky ligj, për respektimin e përzierjes me biokarburant.

Neni 8 Licencimi

1. Personat juridikë, të organizuar si njësi për prodhimin e biokarburanteve ose njësi për përzierjen e biokarburanteve, pajisen me “licencë prodhimi” ose “licencë për përzierje” në përputhje me kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, duke përfshirë edhe procedurat për pezullimin dhe revokimin.

2. Personat juridikë, të pajisur me “licencë prodhimi”, sipas këtij ligji, dhe rafineritë e naftës, të pajisura me leje koncesioni, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, lejohen të realizojnë përzierjen e biokarburanteve me nënproduktet e naftës për transport.

3. Personat juridikë, të pajisur me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”, pajisen me “licencë për përzierje” për të ushtruar veprimtarinë e përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Licenca e prodhimit dhe e përzierjes së biokarburanteve, përfshirë pezullimin dhe revokimin, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VIII.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe jepet nga ministri përgjegjës për energjinë në përputhje me këtë ligj.

5. Veprimtaria e tregtimit me shumicë e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje, përfshihet në licencën “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” dhe licencohet sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6. Licencimi për veprimtarinë e tregtimit me pakicë të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje, bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

7. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose të përzierja, të cilat zëvendësojnë produkte të naftës, quhen gjithashtu nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, duke iu referuar kategorive përkatëse të nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj për këto kategori.

Neni 9 Njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport

1. Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe përzierjes së tyre me nënproduktet e naftës, për transport, në impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport, duhet të jenë të krijuar në formën e shoqërive aksionare.

2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi personat juridikë të pajisen me leje për ndërtimin e impiantit dhe licencë prodhimi sipas nenit 8 të këtij ligji.

3. Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve, të zotëruara nga njësitë e prodhimit, fillon pas vërtetimit të dhënë nga inspektorati shtetëror përgjegjës, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike sipas përcaktimeve të



pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në licencën e prodhimit.

4. Njësitë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë ose përziejnë, në përputhje me standardet në fuqi. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, brenda gjashtë muajve nga miratimi i këtij ligji, vendos publikimin e listës me standardet që do të zbatohen.

5. Njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për energjinë të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për sasinë dhe cilësinë e hedhur në tregun e brendshëm.

Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

6. Ministria përgjegjëse për energjinë publikon në faqen zyrtare të dhëna që promovojnë përdorimin e biokarburanteve dhe bën përditësimin e këtyre të dhënave.

Neni 10

Përgatitja për tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Ruajtja, magazinimi dhe transportimi i biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet e parametrat teknikë dhe të sigurisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet përkatëse, të përfituara nga distilimi i naftës bruto, realizohet vetëm në instalimet e posaçme, të miratuara nga inspektorati shtetëror përgjegjës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Impiantet ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të

rinovueshme, me produktet përkatëse të nënprodukteve të hidrokarbureve, të përfituara nga distilimi i naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina fiskale, doganore ose zona të lira, të pajisura me autorizim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 11

Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Njësitë e prodhimit të biokarburanteve lejohen të tregtojnë prodhimet e tyre të rafineritë e naftës, njësitë e përzierjes së biokarburanteve, shoqëritë e tregtimit me shumicë të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”, të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj dhe t’i eksportojnë ato.

2. Personat juridikë të pajisur me “Licencë për përzierje” lejohen të kryejnë edhe veprimtarinë e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, të shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse”, të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj dhe t’i eksportojnë ato.

3. Shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse”, lejohen të kryejnë edhe veprimtarinë e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj, të shoqëritë e tjera të tregtimit me shumicë të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse”, si dhe t’i eksportojnë ato.

4. Personat juridikë, që kryejnë tregtimin me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me licencë sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, lejohen të shesin me pakicë biokarburante në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duke



zbatuar specifikimet e dhëna në standardet shqiptare në fuqi.

5. Në dokumentacionin përkatës doganor dhe administrativ shoqërues të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duhet të përcaktohen në mënyrë të detyrueshme të dhëna për përqindjen e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përzihen me nënproduktin përkatës të naftës bruto.

6. Personat juridikë, që kryejnë tregtimin me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtojnë edhe biokarburante, janë të detyruara që në instalimet e tregtimit ose në pikat e shitjes së tyre të afishojnë në reklamat dhe pompat e karburantit, në mënyrë të dukshme dhe të qartë, një shënim të posaçëm për:

a) biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, që tregtojnë;

b) diezelin e përzier me biodiezel për lëvizje automjesh në rastet kur përqindja e lëndës bio është mbi nivelin e përqindjes së përcaktuar nga standardet në fuqi;

c) benzinën e përzier me bioetanol për lëvizje automjesh në rastet kur përqindja e lëndës bio është mbi nivelin e përqindjes së përcaktuar nga standardet në fuqi.

7. Karakteristikat, elementet dhe forma e shënimit të posaçëm përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

8. Veprimtaria e transportimit dhe tregtimit të lëndëve djegëse për transport, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe biokarburante, bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Neni 12

Inspektorati shtetëror përgjegjës

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të strukturës përgjegjëse për verifikimin e kritereve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, sipas neneve 6 dhe 7 të këtij ligji, është inspektorati shtetëror përgjegjës, në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Inspektorati shtetëror përgjegjës funksionon sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës shkëmben informacion me strukturat doganore e tatimore në momentin e prodhimit ose importimit, përpara hedhjes së produkteve në treg.

4. Inspektorati shtetëror përgjegjës organizon dhe ushtron kontroll mbi personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore sipas këtij ligji, për kontrollin e treguesve cilësorë për parandalimin e abuzimeve e të falsifikimeve, sipas parashikimit të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Neni 13

Regjimi fiskal

Lehtësitë dhe përjashtimet nga tatimet dhe taksat në lidhje me sasi të biokarburanteve të pastra 100% (njëqind për qind) bio, pa përfshirë pjesën e nënprodukteve përkatëse, të prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, që hidhen në treg për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 6, përcaktohen në ligjet përkatëse të tatimeve dhe taksave.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) për shkeljet e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, me 10 (dhjetë) për qind të vlerës së tregut të sasisë së produktit që mungon nga sasia minimale e përcaktuar, por, në çdo rast, jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje;

b) për shkeljet e pikës 3 të nenit 9 të këtij ligji, me 200 000 (dyqind mijë) lekë;

c) për shkeljet e pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji, me 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) për shkeljet e pikës 5 të nenit 9 të këtij ligji, me 200 000 (dyqind mijë) lekë;

d) për shkeljet e pikës 5 të nenit 11 të këtij ligji, me 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.



2. Kur veprimtaria ushtrohet pa licencat përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, personi juridik dënohet me 2 000 000 (dy milionë) lekë.

3. Masa e gjobës për shkeljet e parashikuara në pikat 1, shkronjat “b”, “c”, “ç”, e “d”, dhe 2 të këtij neni jepet nga inspektorati shtetëror përgjegjës, ndërsa për shkeljet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 jepet nga ministria përgjegjëse për energjinë.

4. Në rast se ministria përgjegjëse për energjinë dhe inspektorati, përkatësisht, sipas kompetencës së dhënies se gjobës, konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji deri në tri herë, procedojnë me bllokimin e zhvillimit të aktivitetit dhe njëkohësisht i propozojnë organit përgjegjës të licencimit për revokimin e licencës.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” dhe me ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 2; 6, pikat 3 dhe 4; 7, pika 4; 8, pikat 1 dhe 3; dhe 9, pika 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 5, dhe 11, pika 7, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për energjinë që brenda tridhjetë e gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 5 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 16

Dispozita kalimtare

1. Njësitë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve, të cilat operojnë aktualisht në treg, janë të detyruara që brenda dymbëdhjetë muajve nga

hyrja në fuqi e akteve nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji, të plotësojnë kushtet përkatëse dhe të depozitojnë aplikimin pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë për të përfituar licencën e prodhimit dhe të përzierjes.

2. Zbatimi i kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji, do të fillojë njëzet e katër muaj nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor, që përcakton kriteret e qëndrueshmërisë.

Neni 17

Shfuqizime

Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport”, shfuqizohet.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 215, datë 4.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 215, datë 4.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 46/2025, “Për prodhimin, transportimin, tregtimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



DEKRET
Nr. 203, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Romina Gani Xhaja
2. Gazmir Hazbi Shanaj
3. Joana Afrim Qendro

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 204, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Erida Dylber Kaja
2. Kent Erzen Kaja

3. Xhile Muharem Niça
4. Ervin Petrit Balliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 205, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ardita Artur Tasellari
2. Dorian Jovan Gjoka
3. Migena Gjini Cara
4. Besmir Kujtim Sina
5. Leon Besmir Sina
6. Aria Besmir Sina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 206, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kleo Çelnik Torra
2. Pranvera Agim Mena
3. Noel Flamur Mena
4. Kujtim Ali Gecaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 207, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Rabora Isa Ramaj
2. Fatjon Shaban Tota

3. Xhesi Gilbert Galanxhi
4. Olivia Xhesi Galanxhi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 208, datë 3.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eugjent Gjergj Beqiri
2. Giselda Lulzim Melaj
3. Klea Artur Nushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 209, datë 3.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mimoza Themis Laholli
2. Besnik Teufik Ibruli
3. Edmond Koço Katundi
4. Miran Rexhep Shehi
5. Gazmend Rexhep Shehi
6. Marilda Pandeli Qerimi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 210, datë 3.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ausilio Jo Fatos Mehmeti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 211, datë 3.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aldi Mustafa Çeribashi
2. Ferdi Bardhyl Radovicka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 212, datë 3.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alina Agustin Cani
2. Agustin Ali Cani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 372, datë 2.7.2025

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE
PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE
TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2026–2028**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026–2028, sipas lidhjes nr. 1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



URDHËR
Nr. 303, datë 3.7.2025

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR
ARSIMIN, NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË,
MËNYRËN E VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE DHE AFATIN E
DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datë 18.7.2025.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurave që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletin e Njoftimeve

Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES I MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrit nr. 303, datë 3.7.2025, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i MAS-it në institucionet publike të arsimit të lartë si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1	Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë	- 1 anëtar përfaqësues i MAS-it
2	Universiteti Bujqësor i Tiranës	- 1 anëtar përfaqësues i MAS-it
3	Universiteti i Arteve Tiranë	- 1 anëtar përfaqësues i MAS-it



1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i

veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
- të ketë integritet etik dhe profesional;
- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;
- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar;
- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi;
- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;



- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- kërkesë për aplikim;
- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-*Curriculum Vitae*);
- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe njehsimit të diplomës /certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- fotokopje të librezës së punës;
- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;
- vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
- vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;
- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;
- vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 18.7.2025 në një nga këto mënyra:

- a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të Komisionit “ad-hoc” të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “Ad-hoc” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin,

i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatin e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njërive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi:

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi:

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.



Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

URDHËR**Nr. 630, datë 27.6.2025****PËR NDALIMIN E PËRKOHSHËM TË LËVIZJES SË KAFSHËVE TË GJALLA TË LLOJIT DHEN DHE DHI NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, nga ferma në fermë, shtegtimin dhe kullotjen në kullota, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ndalimin e përkohshëm të tregtimit të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në tregjet e kafshëve të gjalla, mjedise të hapura, panairë dhe grumbullime të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në ndryshim nga pika 1 e këtij urdhri, shtegtimi dhe kullotja në kullota të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, është i mundur vetëm në rastet kur plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) Shërbimi Veterinar Rajonal vlerëson se lëvizja e kafshëve për në kullota është jetike për kafshët e llojit dhen dhe dhi;

b) Shërbimi Veterinar Rajonal nga ku do të lëvizin kafshët drejt kullotave të kontaktojë me Shërbimin Veterinar Rajonal që mbulon juridiksionin ku ndodhen kullotat dhe të njoftojë në cilat kullota do të shkojnë kafshët;

c) kafshët do të lëvizin vetëm kur Shërbimi Veterinar Rajonal që mbulon juridiksionin ku ndodhen kullotat në të cilat do të shkojnë kafshët, të konfirmojë se kullotat ndodhen jashtë zonës së mbikëqyrjes 10 km ose ndodhen në zona të pastra nga sëmundja e murtajës së ruminantëve të vegjël;

ç) kafshët lejohen të lëvizin drejt kullotave vetëm kur rezultatet e analizave rezultojnë negative për sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël dhe të shoqërohen me certifikatë shëndetësore veterinare të lëshuar nga veterineri zyrtar;

d) kafshët të transportohen për në kullotë me mjete transporti dhe të shoqërohen nga Shërbimi Veterinar Rajonal;

dh) Shërbimi Veterinar Rajonal që mbulon juridiksionin ku janë kullotat, me mbërritjen e kafshëve në kullotë, të mbikëqyrë statusin shëndetësor të kafshëve për një periudhë jo më pak se 21 ditë, duke bërë mbikëqyrjen për shenja klinike për sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël dhe të marrë mostra për analizim.

e) procesi i lëvizjes së kafshëve për në kullota, koordinohet dhe mbikëqyret nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë.

4. Lejohet lëvizja e kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi vetëm për në thertore, të shoqëruara me certifikatë shëndetësore veterinare, e lëshuar nga veterineri zyrtar.

5. Urdhri nr. 575, datë 9.6.2025, “Për ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në territorin e Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari**



URDHËR
Nr. 632, datë 30.6.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE
TË VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia Administrative	Fshati
3 km			
1	Elbasan	Labinot Mal	Labinot Mal
2	Elbasan	Labinot Mal	Sericë
3	Elbasan	Labinot Mal	Lamoll
10 Km			
4	Elbasan	Labinot Mal	Benë
5	Elbasan	Labinot Mal	Dritas
6	Elbasan	Labinot Mal	Qerret
7	Elbasan	Labinot Mal	Qafë
8	Elbasan	Labinot Mal	Shmil
9	Elbasan	Labinot Fushë	Xibrakë
10	Elbasan	Labinot Fushë	Griqan i Sipërm
11	Elbasan	Labinot Fushë	Griqan i Poshtëm
12	Elbasan	Labinot Fushë	Godolesh
13	Elbasan	Labinot Mal	Guri i zi
14	Elbasan	Labinot Mal	Lugaxhi

15	Librazhd	Polis	Mirakë
16	Elbasan	Shushice	Polis Valë
17	Elbasan	Shushice	Polis i Vogël
18	Elbasan	Labinot Fushë	Labinot Fushë
19	Elbasan	Labinot Fushë	Mengel
20	Elbasan	Bradashesh	Rrilë
21	Elbasan	Funar	Bixellë
22	Elbasan	Funar	Preç e Sipërme
23	Elbasan	Funar	Preç e Poshtme
24	Elbasan	Funar	Branesh
25	Elbasan	Funar	Cërujë
26	Librazhd	Qendër Librazhd	Marinaj
27	Librazhd	Qendër Librazhd	Kuturman

8. Intesifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 633, datë 1.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të



gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Lubelskie	Biała Podlaska	Janów Podlaski*
Pomorskie	Wejherowo	Luzino*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së

murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të



Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës

afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.



3. Urdhri nr. 622, datë 26.6.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Polonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 634, datë 1.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 621, datë 26.6.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin Maqedonisë së Veriut”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 635, datë 1.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Florina	Florina*	
Serres	Amphipolis*	
Thessaloniki	Volvi*	
Xanthi	Xanthi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të



përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin

6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të



Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 581, datë 10.6.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 649, datë 3.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LETONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Kurzemes	Tukuma	Džūkstes*
Vidzemes	Madonas	Cesvaines*
Vidzemes	Madonas	Kalsnavas*
Vidzemes	Valkas	Ērgemes*
Zemgales	Dobeles	Tērvetes*
Zemgales	Jelgavas	Glūdas*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij,



materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.



2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të

Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 484, datë 20.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Letonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre,



materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 655, datë 4.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PESTËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË
SHFAQUR NË SHTETIN E KOSOVËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;
- b) materialit biologjik dhe embrioneve;
- c) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë;
- ç) leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël;
- d) trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël;
- dh) produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë

Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 656, datë 4.7.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 397, DATË 23.4.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË” DHE PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 46, DATË 17.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:

- urdhrit nr. 397, datë 23.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Hungarisë”;

- urdhrit nr. 46, datë 17.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 18, datë 1.7.2025

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (**ligji nr. 8102**), i ndryshuar; vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (**vendimi KKRR nr. 539**), i ndryshuar,

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 1.7.2025, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a., me shkresën nr. 1496 prot. datë 28.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:



Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga Shogëria Rajonale UK Elbasan për vitet 2025–2027

Njësitë	Kategoria e klientëve		Zona e shërbimit	
			Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara Vitet 2025-2027
A. Shërbimi i FU-së			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Njësia Elbasan	1. Klientë familjarë	40	60
		2. Klientë publikë	130	130
		3. Klientë privatë	130	130
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë familjarë	42	60
		2. Klientë publikë	100	130
		3. Klientë privatë	100	130
	Librazhd Rurale	1. Klientë familjarë	26	60
		2. Klientë publikë	60	130
		3. Klientë privatë	60	130
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë familjarë	32	60
		2. Klientë publikë	90	130
		3. Klientë privatë	90	130
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë familjarë	38	60
		2. Klientë publikë	120	130
		3. Klientë privatë	120	130
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë familjarë	38	60
		2. Klientë publikë	120	130
		3. Klientë privatë	120	130
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë familjarë	48	60
		2. Klientë publikë	120	130
		3. Klientë privatë	120	130
B. Shërbimi i KUN-së			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë familjarë	9	15
		2. Klientë publikë	30	30
		3. Klientë privatë	30	30
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë familjarë	15	15
		2. Klientë publikë	25	30
		3. Klientë privatë	26	30
	Librazhd Rurale	1. Klientë familjarë	15	15
		2. Klientë publikë	-	30
		3. Klientë privatë	-	30
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë familjarë	-	15
		2. Klientë publikë	-	30
		3. Klientë privatë	-	30
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë familjarë	6	15
		2. Klientë publikë	6	30
		3. Klientë privatë	6	30
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë familjarë	-	15
		2. Klientë publikë	-	30
		3. Klientë privatë	-	30
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë familjarë	12	15
		2. Klientë publikë	16	30
		3. Klientë privatë	16	30
D. Tarifë fikse shërbimi			Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë familjarë	200	200
		2. Klientë publikë	400	400
		3. Klientë privatë	400	400
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë familjarë	100	200
		2. Klientë publikë	100	400
		3. Klientë privatë	100	400
	Librazhd Rurale	1. Klientë familjarë	100	200
		2. Klientë publikë	100	400
		3. Klientë privatë	100	400



Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë familjarë	60	200
		2. Klientë publikë	150	400
		3. Klientë privatë	180	400
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë familjarë	120	200
		2. Klientë publikë	120	400
		3. Klientë privatë	120	400
Njësia Cërrik *	Njësia Cërrik	1. Klientë familjarë	120	200
		2. Klientë publikë	120	400
		3. Klientë privatë	120	400
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë familjarë	100	200
		2. Klientë publikë	200	400
		3. Klientë privatë	200	400

* Tarifa të pamiratuara nga ERRU-ja, por të vendosura sipas vendimeve të këshillave bashkiakë përkatës.

2. Me vendimin nr. 41, datë 23.10.2024, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Elbasan.

3. Kërkesa e shoqërisë rajonale UK Elbasan sh.a., për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar.

4. Shoqëria Rajonale UK Elbasan aplikon tarifat e miratuara nga ERRU-ja për ish-shoqëritë UK ekzistuese sipas:

- vendimit të KKRR-së nr. 33, datë 11.5.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë ujësjellës Gramsh sh.a.”;

- vendimit të KKRR-së nr. 75, datë 19.10.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Librazhd Përrenjas sh.a.”;

- vendimit të KKRR-së nr. 576, datë 2.12.2022, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.”;

- vendimit të KKRR-së nr. 119, datë 20.10.2020, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Peqin sh.a.”.

5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale;

b) aplikimi për nivel të ri tarifar për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite;

c) përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU-së dhe KUN-së si rezultat i investimeve të parashikuara;

d) tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

6. Gjatë procesit të analizës tekniko-ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Elbasan sh.a. e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, sa i takon moslejimit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;



d) kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

e) orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Rajonale Elbasan sh.a.:

a) t’i kushtohet vëmendja e duhur për përmbylljen sa më parë instalimit të matësve në prodhim dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;

c) të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante), si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

d) të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të pasur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

e) shoqëria duhet të aplikojë për nivel të ri tarifor jo më vonë se muaji qershor 2027, duke qenë se periudha rregullatore do të jetë 2025–2027;

f) të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e investimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;

g) të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e

vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës;

h) të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU-së referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t’u realizuar gjatë periudhës rregullatore, pra në vitet 2025–2027;

i) me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa *on-line* dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë;

j) treguesi i eficiencës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumente mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;

k) t’i kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi eficiencën e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

9. Në mbledhjen e datës 4.6.2025, Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko - ekonomike, ERRU e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifor, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.

10. Me shkresën nr. 317/9, datë 10.6.2025, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifor të shoqërisë rajonale UK Elbasan”, ERRU-ja ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Elbasan, AKUK-së, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Elbasan, Gramsh, Belsh, Cërrik, Peqin, për të cilën nuk është dërguar zyrtarisht asnjë koment.

11. Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr.



539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjorë referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a., si më poshtë:

Tabela nr. 2. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shoqërinë Rajonale UK Elbasan.

Njësiti	Kategoria e klientëve		Tarifat e vendosura nga ERRU për vitet 2025-2027
A. Shërbimi i FU-së			Lek/m ³
Njësia Elbasan	Njësia Elbasan	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	130
		3. Klientë privatë	130
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	100
		3. Klientë privatë	100
	Librazhd Rurale	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	100
		3. Klientë privatë	100
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	100
		3. Klientë privatë	100
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	120
		3. Klientë privatë	120
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	120
		3. Klientë privatë	120
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë familjarë	50
		2. Klientë publikë	120
		3. Klientë privatë	120
B. Shërbimi i KUN-së			Lek/m ³
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë familjarë	15
		2. Klientë publikë	30
		3. Klientë privatë	30
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë familjarë	15
		2. Klientë publikë	30
		3. Klientë privatë	30
	Librazhd Rurale	1. Klientë familjarë	15
		2. Klientë publikë	30
